

FUSHAT PRIORITARE TË NDËRHYRJES PËR TË PARANDALUAR GJENERIMIN E MBETJEVE DETARE NGA PAKETIMET PLASTIKE NË SEKTORIN E USHQIMIT DHE PIJEVE NË SHQIPËRI, BOSNJE HERCEGOVINË DHE MALIN E ZI

Faza 1 Gjetjet
Përmbledhje Ekzekutive



Rreth

Ky publikim u hartua nga Qendra Rajonale e Aktiviteteve për Konsum dhe Prodhim të Qendrueshëm (QRA/KPQ), bazuar në gjetjet e analizës së rrjedhës së materialit dhe analizës së legjislacionit e realizuar nga konsulentët kombëtarë në secilin nga vëndet ku është zbatuar projekti.

QRA/KPQ ka një mandat zyrtar nga Palët Kontraktuese të Konventës së Barcelonës për tu angazhuar në bashkëpunime ndërkombëtare me vëndet të cilat lagen nga Deti Mesdhe në parandalimin e ndotjes nga plastika, përfshirë mbetjet detare dhe inovacionet ne sektorin e biznesit.

Teksti: Alessandra Pomé (QRA/KPQ)

Konsulent kombëtarë:

- ◊ Shqipëri: Instituti I Kërkimeve Urbane (ARrM) and HPC International (Analiza Ligjore)
- ◊ Bosnja dhe Hercegovina: Qendra për Energji, Mjedis dhe Burime (CENER21)
- ◊ Mal I Zi: Nemanja Stanisavljevic dhe Goran Bošković (ARrM drejtuesit e grupit) dhe Azra Vukovic (Analiza e Legjislacionit)

SUPERVIZOR: Magali Outters dhe Pedro Fernández (QRA/ZHQP)

p.fernandez@scprac.org

Dizajn dhe ilustrime: Studio Discursiva

Fotografite: Pixabay dhe Instituti i Kërkimeve Urbane

Tetor 2019

Copyright/Autorësia

Ky publikim mund të riprodhohet, plotësisht ose pjesërisht për qëllime edukative dhe jo fitimprurëse pa lejen e specifikë të (QRA/ KPQ) me kusht që të përmendet burimi. QRA/ KPQ do të dëshironte të merrte një kopje të çdo dotimi i cili ka marë këtë material si referencë. Ky publikim nuk mund të shitet ose përdoret për ndonjë qëllim tjetër tregtar pa autorizim të shkruar nga QRA/ KPQ.

Mohim/Disclaimer

Ky botim u prodhua në kuadrin e një detyre të mbështetur nga Ministria Italiane e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) përmes Llogarisë së Programit Austriak DRIVE. Kjo detyrë është në përputhje me objektivat e projektit BpM (Union for the Mediterranean, UfM), Konsum dhe Prodhim të Qendrueshëm/ Efikasiteti i Burimeve (Sustainable Consumption and Production SCP/Resource Efficiency). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e konsulentëve kombëtarë të përmendur më lart dhe nuk pasqyronë domosdoshmërisht pikëpamjet e QRA/ KPQ, Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit, ose BERZH. Për çdo detaj në përfillimin e këtij raporti është kujdesur QRA/ KPQ, ndërsa as QRA/ KPQ dhe as organizatat financuese nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për çfarëdo humbje që mund t'i shkaktohet një personi (duke përfshirë por pa u kufizuar në humbje të drejtpërdrejta, të tërthorta, apo humbje të fitimit, të të dhënave ose humbje ekonomike), apo dëmtim, kosto, pretendim ose shpenzim që shkaktohet duke u mbështetur në këtë raport ose nga përmbajtja e tij (përveç se nëse kjo parashikohet në ligj). QRA/ KPQ nuk ka verifikuar në mënyrë të pavarur informacionet që përfshihen në raport dhe nuk pranon asnjë përgjegjësi për cilindo nga informacionet e tij, apo për përcaktime të pasakta ose përjashtime në të.

Shkurtime

RrNA

Rrjetet Nervore Artificiale

RBBH

Rajoni Brcko në Bosnje
Herzegovinë

BH

Bosnja dhe Hercegovina

VKM

Vendimi i Këshillit të Ministrave
(Shqipëri)

SKD

Sistemi i Kthimit të Depozitave

BERZH

Banka Evropiane për Rindërtim
dhe Zhvillimi

PZP

Përgjegjësia e Zgjëruar e
Prodhuesit

BE

Bashkimi Europian

Sektori i UP

Ushqim dhe Pije

FBH

Federata e Bosnjës dhe
Herzegovina

PPUP

Paketimi Plastik nga Sektori i
Ushqimit dhe Pijeve

IHD

Investimet e Huaja Direkte

PBB

Prodhimi i Brendshëm Bruto

GIZ

Shoqëria Gjermane për
Bashkëpunim Ndërkombëtar

PGjP

Prokurimi i Gjellbër Publik

PMVI

Programit të Monitorimit dhe
Vlerësimit të Integruar

MIMMTD

Ministria Italiane e Mjedisit dhe
Mbrojtjes së Tokës dhe Detit

SIR

Sektori Informal i Riciklimit

KM

Kthehen në Mbetje

NJQV

Njësia e Qeverisjes Vendore

ARrM

Analiza e Rrjedhës së Materialit

MNB

Mbetjet e Ngurta Bashkiake

OBEZh

Organizata për Bashkëpunim
Ekonomik dhe Zhvillim

HT

Hedhura në Treg

PP

Paketimi plastik

OPP

Organizatat e Përgjegjësive të
Prodhuesve (OPP)

K & Zh

Kërkimi dhe zhvillimi

RK

Republika e Kroacisë

QRA/KPQ

Qendra Rajonale e Aktiviteteve
për Konsum dhe Prodhim të
Qendrueshëm

SIDA

Agjensia e Bashkëpunimit
Ndërkombëtar të Zhvillimit Suedez

NVM

Ndërmarrje e Vogla dhe të
Mesme

PKBM/ PVDM

Programi i Kombeve të Bashkuara
për Mjedisin/ Plani I Veprimit në
Detin Mesdhe

Paketimet plastike, veçanërisht nga sektori i ushqimit dhe pijeve (UP), përfaqësojnë pjesën më të madhe të mbetjeve detare që mund të gjenden në plazhe, fundin e detit dhe ujrat e Detit Adriatik dhe Jon¹. Pjesa më e madhe e plastikës vjen nga keq menaxhimin i mbetjeve të gjeneruara nga veprimtaritë e vendosura në tokë, kryesisht nga familjet dhe bizneset e shërbimeve, shpesh të lidhura me sektorin e turizmit dhe rekreacionit.

Referuar Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP²), krahasuar me të gjithë sektorët të cilët operojnë në fushën e mallrave të konsumit, **sektori i pijeve jo alkoolike është ndër përdoruesit më të mëdhenj të plastikës e përdorur kryesisht si ambalazh një përdorimësh**, siç janë qeset e lehta plastike dhe shishet e ujit, ndërsa sektori i tregëtisë me pakicë dhe ushqimeve përdor më shumë plastikë për 1 milion \$ të ardhura ndoshta edhe për shkak të bashkëpunimit të tyre me sektorin e bujqësisë. Kompanitë në sektorin e ushqimit dhe pijeve joalkoolike për këtë arsye kanë më shumë të ngjarë të

përballen me rreziqe reputacionale dhe legislative për shkak të lidhjes ndërmjet produkteve ushqimore me plastikën dhe ndikimit që ato kanë në mjedis kryesisht ato që depozitohen në mënyrë të pa kontrolluar në mjedis. Këto rreziqe, ose mundësi që kanë të bëjnë me ambalazhet plastike, mund të kenw njw vlerë të konsiderueshme pwr këto biznese nëse do të duhej që kostoja e plotë e ndikimeve të produkteve tw tyre në mjedis të mbulohej nga vetë ata.

Në kuadër të përmbushjes së përgjigjesive të ngarkuara nga Program i Punës³ së KB për Mjedisin/ PVDM (Plan i Veprimit në Detin Mesdhe) dhe Planit Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Detin Mesdhe, Qendra Rajonale e Aktiviteteve për Konsumin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm (QRA/ KPQ) është e **angazhuar të sigurojë mbështetje teknike dhe financiare për Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën (BH) dhe Republikën e Malit të Zi (Mali i Zi) për të përmirësuar kornizën e politikave dhe për të angazhuar industrinë lokale të UP-ve në një përpjekje për të zvogëluar dhe parandaluar gjenerimin e mbetjeve të paketimeve plastike.**



1. Vlachogianni, Th., Anastasopoulou, A., Fortibuoni, T., Ronchi, F., Zeri, Ch., (2017) Vlerësimi I Mbetjeve Detare në Detet Adriatik dhe Jon. Projekti IPA- Adriatic DeFishGear, MIO-ECSDE, HCMR dhe ISPRA. faqa 168 (ISBN: 978-960-6793-25-7).


2. UNEP (2014) Vlerësimi i Plastikës: Rasti i biznesit për matjen, menaxhimin dhe zbulimin e përdorimit të plastikës në industrinë e mallrave të konsumit.

3. Aktiviteti 2.11.2 "për të promovuar përdorimin e instrumenteve dhe incentivave përkatëse për të zvogëluar / ndaluar përdorimin plastikës një përdorimshe, zvogëlimin e përdorimit të shisheve plastike etj."

Për këtë arsye, QRA/KPQ porositur që të zhvillohet analiza e gjendjes bazë në të tre vendet për këto çështje:

» **Analiza e Rrjedhës së Materialit** për të pasur një ide paraprake të sasive të paketimeve plastike në sektorin e ushqimit dhe pijeve (PPUP) që hidhen në treg (HT) dhe kthehen në mbetje (KM), si dhe rekomandime për të rritur këto njohuri – kjo veprimtari mbwshtetet nga Ministria Italiane e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit

» **Analizat e Legjislacionit** për të identifikuar barrierat pwr vwnien në zbatim tw parimeve të cirkularitetit të lidhur me paketimin plastik në industrinë e UP-ve, nga këndvështrimi i sektorit publik dhe privat – kjo veprimtari mbwshtetet nga Ministria Italiane e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit (MIMMTD) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)



Rezultatet kryesore të këtyre studimeve paraprake janë përmbledhur në kapitujt vijues:

Kapitulli 1 bazohet në gjetjet e rrjedhës së materialeve dhe analizës së legjislacionit për të prezantuar sektorin e UP-ve në vendet përfituese dhe kontributin e tij relativ në gjenerimin e mbetjeve nga keq menaxhimi i paketimeve plastike. Ai nxjerr në pah përparimet kryesore të arritura dhe sfidat e përbashkëta me të cilat janë përballur të tre vendet në përafrimin e kuadrove të tyre ligjore të lidhura me Dispozitat e Konventës së Barcelonës dhe acquis të Bashkimit Evropian (BE) të lidhur me paketimet plastike dhe avancimin përpara në kalimin në një sistem paketime plastik të bazuar në ekonomin qarkulluese. Në fund sugjerohen një sërë fushash prioritare për ndërhyrje për arritjen e këtyre qëllimeve, veçanërisht nga perspektiva e politikës publike. Fushat e ndërhyrjes do të plotësohen në fazat e mëvonshme, pas organizimit të aktiviteteve për angazhimin e palëve të interesuara me bizneset private dhe organizatat e mbështetjes së biznesit.

Kapitulli 2 detajon rezultatet e ArrM-ve dhe Analizat e Legjislacionit për Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi.

Kapitulli 3 paraqet një tabelë përmbledhëse me gjetjet e analizës së legjislacionit për secilin nga vendet ku është zbatuar projekti.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Puna me sektorin e ushqimit dhe pijeve për të luftuar mbetjet detare në tre vende të Adriatikut

8

1.1. Mbetjet nga paketimet plastike: prodhimi dhe menaxhimi në vendet përfituese

13

1.2. Progresi në kalimin në një ekonomi qarkulluese për paketimet plastike

15

1.3. Sfidat e përbashkëta dhe fushat prioritare të ndërhyrjes

18

1.4. Hartimi i aktiviteteve të projektit për të adresuar sfidat e përbashkëta

2. Gjetjet kryesore nga Analiza e Rrjedhës së Materialit dhe Rishikimi i Legjislacionit në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Malin e Zi

21

2.1. Shqipëria

24

2.2. Bosnje dhe Hercegovina

27

2.3. Mali i Zi

3. Analiza e legjislacionit – tabelat përmbledhëse

33

3.1. Shqipëria

38

3.2. Bosnje dhe Hercegovina

46

3.3. Mali i Zi



KAPITULLI 1

PUNA ME SEKTORIN

E USHQIMIT DHE

PIJEVE PËR TË

LUFTUAR MBETJET

DETARE NË TRE

VENDE TË ADRIATIKUT



1.1. MBETJET NGA PAKETIMET PLASTIKE: PRODHIMI DHE MENAXHIMI NË VENDET PËRFITUESE

Siç vlerësohet nga [Qendra Rajonale e Konkurrencës OECD/GVH](#), në Shqipëri, Malin e Zi dhe Bosnje Hercegovinë, **prodhimi fillestar i ushqimit dhe pijeve është tepër i fragmentuar** dhe mbizotërohet nga firma të vogla me aftësi të kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare. **Sektori i shitjes me pakicë**, nga ana tjetër, është centralizuar gjithnjë e më shumë duke kaluar nga dyqanet e vogla të lagjeve në supermarketet mëdha. Shitësit me pakicë në sektorin e UP-ve karakterizohen sot nga centralizimi dhe investimet e huaja, linjat e mëdha të supermarketeve po marrin kontrollin mbi prodhimin duke preferuar të bashkëpunojnë me furnizues të konsoliduar, gjë e cila ka çuar në shtimin e produkteve të UP-ve të importuara në supermarketet e tyre.

Fuqia e prodhuesve vendas në sektorin e UP-ve po zvogëlohet gjithnjë e më shumë. Rritja e sektorit të përpunimit të UP-ve në të tre vendet penalizohet më tej nga investimet e huaja direkte (IHD) të cilat janë të kufizuara

në krahasim me xhiron totale të sektorit. Ka gjithashtu kërkitime të limituara në sektorin agro-ushqimor së bashku me hulumtime të tjera të cilat janë të fragmentuara dhe shpesh përdorin teknika të vjetruara të cilat kanë lidhje të dobëta ndërmjet industrisë dhe shkencës faktor ky i cili lidhet edhe me shpenzimet e vogla për K&Zh të ndërmarra nga ana e kompanive.

Reformat e politikave për të rritur konkurrencën e sektorit UP-ve, duhet të synojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm biznesi si dhe të ngrenë aftësitë dhe kapacitetet në mënyrë që të përmirësojnë qeverisjen e përgjithshme. **Kalimi drejt prodhimeve pa përmbajtje plastike mund të ofrojë mundësi për bizneset lokale të UP-ve për të qenë në një pozicion më të avantazhuar në raport me produktet e UP-ve të cilat vijnë nga importi.**

Referuar gjetjeve të përfuara nga Analiza e Rrjedhjes së Materialit (ARrM), Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina gjenerojnë **afërsisht 45 kg, 34 kg dhe 31 kg mbetje nga Paketimi Plastik nga sektori i Ushqimit dhe Pijeve (PPUP) për person në vit përkatësisht**, pavarësisht popullsisë dhe ekonomisë së tyre të vogël.

Analiza e Rrjedhës së Materialit (ARrM)

Metoda e Analizës së Rrjedhës së Materialit (ARrM) u përdor për të vlerësuar rrjedhën dhe stoqet e paketimit plastik në sektorin e ushqimit dhe pijeve (PPUP) në Bosnje Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri me qëllim identifikimin e sasisë, burimit dhe rrugën e materialit në fjalë, për të vazhduar më tej me projektin.

Për të tre vendet, kufiri hapësinor i sistemit të ARrM-së përkoi me kufijtë shtetëror. Për të tejkaluar problematikat me të dhënat ndër vite, kufiri i përkohshëm i sistemit u përcaktua një vit fillestar: 2017 për BH, 2018 për Shqipërinë dhe Malin e Zi. Në rastin se të dhënat për vitin fillestar nuk ishin të disponueshme, u përdorën të dhënat më të fundit të disponueshme. Fazat e konsideruara brenda tre sistemeve janë: procesi i prodhimit, përpunimit dhe bujqësisë, procesi i konsumit dhe procesi i menaxhimit të mbetjeve.

Sasitë e PPUP në të tre sistemet u llogaritën duke përdorur dy metodologji – një qasje nga poshtë-lart e përdorur për të lidhur të dhënat dhe përlllogaritur sasitë e PPUP-së, në përputhje me Direktivën Kuadër për Mbetjet të BE-së dhe metodologjinë e bazuar në Rrjetet Nervore Artificiale/ Artificial Neural Networks (RrNA), për të kryer një kontroll të kryqëzuar të të dhënave. Sasitë e përfuara përmes aplikimit të modelit RrNA u përfshinë në metodologjinë ARrM në të tre vendet, pasi vlerat e përfuara kanë një nivel të ulët pasigurie.

Në përfundim, të gjitha raportet nxjerrin në pah faktin se sasitë e përfuara duhet të përdoren kryesisht si një mjet për të kuptuar trendin potencial të rrjedhës së materialit.

Konsideruar se në vitin 2012, referuar **Merges-Alliances**, 51% e mbetjeve nga paketimet plastike në BE gjenerohen nga sektori ushqimor dhe 18% nga sektori i pijeve, mund të vlerësojmë se në vitin 2015 Kroacia gjeneroi 8 kg mbetje nga PPUP për person në vit, Irlanda 41 kg/ person/ vit dhe vendet e BE-së mesatarisht 21 kg/ person/ vit . Për të krahasuar sasinë e vlerësuar të mbetjeve nga PPUP të gjeneruara nga Shqipëria, Mali i Zi dhe BH për person në vit është analoge me sasinë e gjeneruar në Irlandë dhe deri në 5 herë më e lartë se ajo e gjeneruar në Kroaci, të dy këto vende kanë popullsi të përafërt me popullsinë e Shqipërisë dhe BH por me një **ekonomi shumë më të gjerë**.

5. Kjo është sasia e përgjithshme e Paketimeve Plastike të Ushqimit dhe Pijeve (PPUP) të Hedhura në Treg (HT), e cila është grumbulluar dhe pjesërisht hyn në rrjedhën e mbetjeve (RrM) dhe pjesërisht e hedhur në mjedis ose vend depozitime të pa kontrolluara.


6. Siç është raportuar nga **Panday et al.**, Rrjetet Nervore Artificiale (RrNA) janë “një teknikë kompjuterike e frymëzuar biologjikisht që imiton procesin e të mësuarit të sjelljes së trurit të njeriut. [...] RrNA-të janë përafëse universale dhe parashikimet e tyre bazohen në të dhëna paraprake të disponueshme”. Modeli i bazuar në RrNA është përdorur për të parashikuar sasinë dhe përbërjen e mbetjeve në të ardhmen në Serbi në 2011 (**Batinic et al., 2011**).

7. Këto vlera korrespondojnë me 69% të sasisë së përgjithshme të mbetjeve plastike të paketimit (në kg) të gjeneruara për person në vit në Kroaci (12 kg / person / vit), Irlandë (60 kg / person / vit) dhe mesatarisht në vendet e BE (31 kg / person / vit) në vitin 2015. Burimi: <https://ec.europa.eu/eurostat/en/web/products-eurostat-news/-/EDN-20180422-1>

Sasia e mbetjeve nga paketimi plastik në sektorin e ushqimit dhe pijeve (PPUP) në kg për person në vit në vendet në të cilat është zbatuar projekti (kollonat , Vlerësimet e autorit) si dhe krahasimi me PBB/ për banorë (pikat).

(Viti bazë: 2017 për BH, 2018 për Shqipërinë dhe Malin e Zi, 2015 për Kroacinë, Irlandën dhe BE-në)

	PPUP mbetje/ banorë/vit	Popullsia	PBB/banorë
SHQIPËRI	45 kg	2,870,000	\$4.530
BH	31 kg	3,510,000	\$4.786
MALI I ZI	34 kg	622,000	\$6.431
KROACI	8 kg	4,076,246	\$14.916
IRLAND	41 kg	4,853,506	\$77.449
BE-MESATARJA	21 kg	512,600,000	\$36.676




Në të tre vendet në përfituese, një sasi e mabde mbetjesh nga PPUP nuk arrihet të grumbullohet nga Sistemi i Menaxhimit të Mbetjeve, gjë e cila çonë në depozitimin e një sasive të konsiderushme mbetjesh në mënyrë të pa kontrolluar, në mjedis:

Sasitë e vlerësuara të mbetjeve të PPUP të mbledhura përkundrejt atyre të depozituara në mënyrë të pa kontrolluar dhe atyre të hedhura në mjedis në vendet e projektit (Vlerësimet e autorit)

(Të dhënat bazë: 2017 për BiH; 2018 për Shqipërinë dhe Malin e Zi)

- Mbetje PPUP të depozituara ose hedhura në mjedis (kg/banorë/vit)
- Mbetje PPUP të grumbulluara (kg/banorë/vit)



Përafërsisht 14 kg PPUP për person përllogaritet të depozitohet në mënyrë të pakontrolluar në Shqipëri çdo vit. Kjo është afërsisht e **barabartë me më shumë se 2.6 milion shishe Coca-Cola 2L⁸ që përfundojnë në mjedis çdo ditë në Shqipëri !**

Në BH, shumica e përafërsisht është 7 kg/ person/vit e cila është e **barabartë me gati 1.6 milion shishe Coca-Cola 2L që përfundojnë në mënyrë të pakontrolluar në mjedis çdo ditë!**

Me më pak se **4 kg mbetje nga PPUP të depozituara në mënyrë të pakontrolluar për person në vit**, Mali i Zi duket se po performon më mirë me grumbullimin e mbetjeve nga paketimet plastike. Kjo mund të jetë edhe për shkak të përqendrimit të lartë të popullsisë në zonat urbane, ku vitet e fundit janë bërë shumë përpjekje për përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane.

8. Mesatarisht, një shishe Coca-Cola plastike 2L peshon 42g. Vlerësohet se në 1 kg ka 24 shishe plastike 2L. Burimi: <https://www.quora.com/How-many-empty-2L-coke-plastic-bottles-is-1kg>.




Pjesa më e madhe e mbetjeve nga PPUP gjenerohet nga familjet dhe NVM-të të cilat shpesh përfundojnë në vend-depozitime të pa kontrolluara të cilat depozitohen së bashku me pjesën tjetër të mbetjeve të ngurta urbane. Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve, veçanërisht në zonat urbane, **përqindjet e mbetjeve nga PPUP të cilat grumbullohen në mënyrë të diferencuar janë pothuajse të pa përfillshme në të tre vëndet.** Me rreth 7% të mbetjeve nga PPUP të ricikluara Shqipëria mbanë shkallën më të lartë të riciklimit nga vendet në të cilat zbatohet projekti, kjo edhe për shkak të një Sistemi të gjerë Ricikluesish Inofmal (SRI).

Ndarja e mbetjeve të PPUP-ve të mbledhura për çdo vend. (Vlerësimet e autorit)

(Të dhënat bazë: 2017 për BH; 2018 për Shqipërinë dhe Malin e Zi)

- Ricikluar
- Në lëndfille sanitar dhe incenerator
- Në lëndfille vend depozitime jo sanitare



Mundësitë e trajtimit fundor (end-of-life) në tre vendet e Adriatikut

- ◇ Të ricikluara / riciklimi: trajtimi i mbetjeve me të cilin materiali është rikuperuar për t'u përdorur në prodhimin e produkteve të njëjta ose të tjera. Riciklimi është procesi i shndërrimit të materialeve të mbetjeve në materiale dhe objekte të reja.
- ◇ Lëndfill-et: metoda e depozitimit të mbetjeve ku mbetjet depozitohen nëntokë ose në grumbuj të mëdhenj. Kjo metodë e depozitimit të mbetjeve kontrollohet dhe monitorohet shumë nga afër, përfshirë masat për trajtimin e leksivateve (lëngjeve që dalin nga trajtimi i mbetjeve).
- ◇ Incenerator: impianti i trajtimit të mbetjeve i cili përfshin djegien e substancave organike në përbërje të mbetjeve. Incenerimi i materialeve të mbetjeve shndërron mbeturinat në hi, gaz dhe

nxehhtësi. Në disa raste, nxehhtësia e krijuar nga djegia mund të përdoret për të gjeneruar energji elektrike.

- ◇ Vend depozitimet jo sanitare: metoda themelore e depozitimit të mbetjeve që nuk kanë standarde dhe procese për t'u konsideruar si depozitime sanitare, përfshirë mungesën e monitorimit, mbulimin e duhur dhe trajtimin e leksivateve (lëngjeve që dalin nga trajtimi i mbetjeve). Ata gjithashtu quhen "depozitime të kontrolluara".
- ◇ Vend depozitimet e pa kontrolluara: hedhja e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar në vendet që nuk janë të dedikuara posaçërisht për këtë qëllim (rrugë, basene ujore, etj.). Prandaj, shpesh referohen si vend depozitime të jashtëligjshme.

Pavarësisht vështirësisë për të gjetur të dhëna statistikore të besueshme dhe cilësore në lidhje me prodhimin e PPUP-së, tregtisë dhe menaxhimit të mbetjeve në të tre vëndet, gjetjet e ARrM-së tregojnë qartë **nevojën urgjente për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve** në të gjitha nivelet, nivel kombëtar/lokal dhe në nivel kompanie/korporate për të arritur një ulje të konsiderueshme të sasisë të keq menaxhuar të mbetjeve nga PPUP të cilat nëse nuk menaxhohen në mënyrën e duhur mund të përfundojnë në lumenj e në fazën përfundimtare në det. Ndërkohë që përmirësojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve shtetet dhe kompanitë e ndryshme që operojnë në këtë sektor kanë mundësinë të krijojnë një **kuadër ligjor dhe adoptojnë praktika të mira të cilat parandalojnë gjenerimin e mbetjeve nga plastika, të cilat më pas përfundojnë në det, në burim.**

9. Është për tu theksuar se të gjitha vlerësimet e gjeneruara në kuadrin e Analizave të Rrjedhës së Material (ARrM) vijnë me një shkallë të ndryshme pasigurie. Për këtë arsye, gjetjet e ARrM-së duhet të përdoren kryesisht për të kuptuar tendencat aktuale dhe të ardhshme të materialit.



1.2. PROGRESI NË KALIMIN NË NJË EKONOMI QARKULLUESE PËR PAKETIMET PLASTIKE

Si Palë Kontraktuese në Konventën e Barcelona, Shqipëria, BH dhe Mali i Zi janë të angazhuara të marrin masa parandaluese në lidhje me menaxhimin e mbetjeve detare, si dhe të përmirësojnë sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, aderimi në Bashkimin Evropian (BE) është një nxitës i shkëlqyeshëm.

Gjetjet nga analiza e legjislacionit për të tre vendet tregojnë se **legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve përfshi këtu edhe mbetjet nga paketimet plastike është i ngritur**, implementimi dhe zbatimi i tij lë për të dëshiruar. Incentivat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, taksat dhe gjobat, nuk janë përfshirë plotësisht në legjislacionin

ekzistues ose edhe kur janë përfshirë ato nuk zbatohen.

Tabela e mëposhtme ilustron statusin aktual në adoptimin dhe implementimin e politikave dhe masava ekonomike për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve nga PPUP duke u drejtuar drejt një sistemi të ekonomisë qarkulluese. Një përshkrim më i detajuar i situatës në të tre vendet është përshkruar në [Kapitullin 3](#).

Progresi relativ i vendeve në miratimin dhe zbatimin e instrumenteve të politikave për të adresuar plastikëndhe prodhimin e paketimeve të plastikës si dhe gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve

- Nuk është e rregulluar
- Rregulloret janë miratuar por nuk janë zbatuar plotësisht për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera

INSTRUMENTAT POLITIK TË CILËT ADRESOJNË PPUP	Shqipëria	Mali i Zi	Bosnje dhe Hercegovina		
			Federata e Bosnje dhe Hercegovinës	Republika e Serbisë (RS)	Rajoni Brcko i BH (RD BH)
Objektivat e Riciklimit					
Rregullimi i Menaxhimit të Mbetjeve					
Rregullimi i Menaxhimit të mbetjeve nga paketimi plastik					
Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit (PZP)					
Sistemi i Kthimit të Depozitës					
Shkurajime/Dizincitiva Ekonomike					
Incentiva Ekonomike					
Ndalim për produktet me impakt negativ në mjedis					
Eko Etiketa					
Eko Inovacioni dhe Eko Dizajni					
Prokurimi i Gjellbër Publik (PGjP)					



1.3. SFIDAT E PËRBASHKËTA DHE FUSHAT PRIORITARE TË NDËRHRYJES

Bazuar në rezultatet e analizës së rrjedhës së materialit dhe rishikimit të legjislaacionit, një përmbledhje paraprake e sfidave të përbashkëta dhe fushave prioritare të ndërhyrjes është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Këto gjetje do të plotësohen në fazat e mëvonshme të projektit, pas aktiviteteve për angazhimin e palëve të interesuara me bizneset private dhe organizatat e mbështetjes së biznesit.

Sfida të përbashkëta: Baza e njohurive dhe të dhënat

Qeverive u mungojnë të dhëna të besueshme, cilësore për prodhimin e paketimit plastik, tregtinë, gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve për të hartuar politika të përshtatshme, për të monitoruar progresin dhe për të informuar industrinë vendase dhe publikun.

Fushat Prioritare të Ndërhyrjes

- ◇ Përmirësimi i njohurive dhe disponueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës së të dhënave në përputhje me zbatimin e Programit të Monitorimit dhe Vlerësimit të Integruar (PMVI)¹⁰ dhe përafrimi i sistemeve të raportimit me EUROSTAT, duke u bazuar në përvojën e vendeve të BE-së.
- ◇ Rritja e kapaciteteve dhe përcaktimi i roleve dhe përgjegjësisë të qarta në kuadrot institucionale për të përmirësuar monitorimin, forcimin e implementimit të politikave, zbatimin dhe pajtueshmërinë.
- ◇ Përmirësimi i koordinimit, harmonizimit dhe dialogut ndërmjet autoriteteve përkatëse dhe palëve të interes (p.sh., prodhuesit e PP, shitësit me pakicë, përpunuesit e UP-ve, bashkitë, Organizatat e Përgjegjësive të Prodhuesve (OPP), për të gjeneruar të dhëna cilësore dhe për të populluar bazat e të dhënave dhe ato të vihen në dispozicion të publikut.
- ◇ Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nën-rajonat dhe ndarjen e praktikave të mira.

10. PMVI është një arritje kryesore në Konventën e Barcelonës, e cila do të mundësojë për herë të parë një analizë të integruar sasiore të gjendjes së mjedisit detar dhe bregdetar e cila mbulon ndotjen dhe mbetjet detare, biodiversitetin, speciet jo homogjene, bregdetin dhe hidrografinë, bazuar në treguesit e përbashkët rajonal, synimet për një status Mjedisor më të mirë.

Sfida të përbashkëta: Sistemet e menaxhimit të mbetjeve

Sistemet ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve (mbledhja, ndarja, trajtimi) janë zakonisht të gabuara, joefikase, duke çuar në një shkallë të ulët të grumbullimit, ndarjes dhe riciklimit.

Fushat Prioritare të Ndërhyrjes

- ◇ Ligje për të zvogëluar depozitimin/hedhjen e paligjshme, minimizimin e mbetjeve të depozituara në lëndfill, zgjerimin e programeve të riciklimit dhe vënien në punë të skemave të përgjegjësive së zgjeruar të prodhuesit (PZP) të cilat janë miratuar në mënyrë të qëndrueshme, por ato duhet të dekretohen dhe zbatohen me urgjencë.
- ◇ Hartimi i skemave të PZP-së për të inkurajuar parandalimin ose ripërdorimin e materilave më shumë se riciklimin. Skemat PZP mund të integrojnë një sistem të kthimit të depozitave (SKD) për të rritur grumbullimin e diferencuar të paketimeve plastike dhe sasinë e materialit plastik të pastër që hyn në zinxhirin e vlerës së riciklimit.
- ◇ Sigurohuni që vendet kanë aftësinë për të ricikluar mbetjet e tyre plastike në territorin e tyre, duke zvogëluar kështu importin / eksportin e skrapit plastik.

Sfida të përbashkëta: Pjesëmarrja e konsumatorit

Blerja, konsumimi dhe sjellja e konsumatorëve (përfshirë familjet dhe shërbimet ushqimore) gjatë depozitimit të mbetjeve janë identifikuar si faktorë kryesor që çojnë në keqmenaxhimin e mbetjeve të paketuara plastike të cilat kanë gjasë të depozitohen përfundimisht në mjedisin detar. Sjellja e konsumatorit është thelbësore në të gjitha fazat e zinxhirit të produktit nga prodhimi në depozitimin fundor të mbetjeve të PPUP-ve dhe ka të ngjarë të ndikohet nga njohja, qëndrimet dhe niveli i shqetësimit për çështjet mjedisore, së bashku me motivimin për t'u përfshirë në zgjidhje.

Fushat Prioritare të Ndërhyrjes

- ◇ Hartimi dhe implementimi i fushatave të ndërgjegjësimit për mbetjet detare të gjeneruara nga PPUP-të që synojnë një audiencë specifike dhe llojin specifik të mbetjeve detare: sa më specifike të jetë fushata aq më e lehtë është të përcaktoni objektiva të matshëm të cilat nga ana e tjetër do të bëjnë më të lehtë matjen drejtpërdrejt të suksesit (p.sh. **Fushata mos u bëj Vulgar në Australi**).
- ◇ Peticione ndaj Qeverisë (eve) për mbetjet specifike detare të PPUP-së për të maksimizuar rezultatet pasi çdo reagim nga qeveria ka të ngjarë të jetë publik në natyrë.
- ◇ Hartimi dhe implementimi i programeve të edukimit mjedisor për të edukuar prodhuesit lokalë të UP-ve dhe shërbimeve ushqimore, të cilët punojnë me materiale plastike në baza të rregullta për t'i inkurajuar ata të adoptojnë një qasje më të ndërgjegjshme kur merren me plastikë, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet e paqëllimshme në mjedis (p.sh. **Iniciativa Zero Peletë në Gjermani**).
- ◇ Promovimi i bashkëpunimit midis aktorëve të cilët merren me mbetjet detare dhe krijimi i rrjeteve të forta që merren me problemet e detit (p.sh., **Partneriteti Global për Mbetjet Detare**).
- ◇ Promovimi i praktikave vullnetare 'zero mbetje plastike' brenda shërbimeve ushqimore.
- ◇ Aplikimi i Prokurimit të Gjellbër Publik për të siguruar informacion dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet që mund të kenë bizneset në aplikimin e alternativave më të gjellbërta/ miqësore me mjedisin të cilat do ti ndihmojnë ato edhe për të forcuar tregun e tyre.

Sfida të përbashkëta: Konkurrueshmëria e biznesit

Sot konsumatorët janë gjithnjë e më të vetëdijsëm për ndikimet mjedisore të paketimit plastik. Ulja e intensitetit të tyre plastik mund të sigurojë një avantazh konkurrues për bizneset lokale të UP-ve në BH, Shqipëri dhe Mal të Zi, të cilët po përpiqen të konkurrojnë me mallrat e importuara të UP-ve. Marrja në konsideratë e kufizimeve mjedisore, megjithatë mbetet problematik për shumicën e NVM-ve dhe bashkëpunimi i dobët përgjatë zinxhirit të vlerës shpesh pengon inovacionin.

Fushat Prioritare të Ndërhyrjes

- ◇ Ofroni mundësi trainimi profesional për të ngritur kapacitetet dhe aftësitë në mënyrë të tillë që NVM-të krijojnë produkte të qëndrueshme dhe të operojnë brenda sistemeve të qëndrueshme industriale. Tërheqja, zhvillimi dhe ruajtja e këtyre kapaciteteve është thelbësore për arritjen e rritjes organizative përmes inovacionit.
- ◇ Siguroni incentiva/stimuj që bizneset të investojnë dhe të adoptojnë teknologji dhe praktika më të gjelbërta/ miqësore me mjedisin - p.sh. për të përdorur materiale dhe energji në mënyrë më efikase, për shembull nga:
 - » vendosja e çmimeve dhe sfidave të biznesit për eko-dizajn ose eko-inovacionin;
 - » promovimi i Prokurimit të Gjellbër Publik për të stimuluar eko-dizajnin dhe eko-inovacionin në vend;
 - » hartimin e programeve PZP për të promovuar eko-inovacionin në rrjedhën e sipërme të materialit;
 - » përmirësimin e sistemeve të mbështetjes publike, ndërmjetësuese dhe private për sipërmarrësit (të tilla si universitete, inkubatorë, organizata të zhvillimit të biznesit, ofruesit e shërbimeve të projektimit, financuesit dhe agjentët);
 - » zhvillimi dhe promovimi i mekanizmave të ndryshëm financiarë (p.sh. grante, kredi) që mbulojnë të gjithë ciklin e rritjes së NVM-ve dhe adresojnë nevojat e të gjitha llojeve të NVM-ve (pre fillestare, fillestare, i stazhonuar);
 - » prezantimi i mekanizmave të rinj dhe programeve stimuluuese për të promovuar transferimin e teknologjisë ndërmjet akademisë dhe sektorit privat.
 - » Identifikoni sinergjitë midis zinxhirëve të furnizimit dhe autoriteteve përkatëse lokale për të inkurajuar përdorimin e nënprodukteve (p.sh., mbetjeve bujqësore) si lëndë të parë që do të ri-përpunohen për paketimin e gjelbër inovativ në zinxhirët e mëtejshëm të furnizimit, duke favorizuar kalimin drejt një ekonomie qarkulluese më të qëndrueshme dhe uljen e përdorimit të burimeve të virgjëra, emetimet e karbonit dhe gjenerimit të mbetjeve.

Sfida të përbashkëta: Angazhimi i shitësve me pakicë

Në ndërfaqen midis prodhimit dhe konsumit, shitësit me pakicë mund të luajnë një rol kryesor në promovimin e modeleve të qëndrueshme të konsumit.

Fushat Prioritare të Ndërhyrjes

- ◇ Angazhoni shitësit me pakicë në marrëveshje dhe aktivitete vullnetare për të zvogëluar paketimin plastik dhe për të lëvizur drejt një modeli biznesi që gjeneron zero mbetje plastike dhe për t'u ofruar atyre mbështetje teknike përmes këshillave të pavarura dhe udhëzuesve në dispozicion.



1.4. HARTIMI I AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT PËR TË ADRESUAR SFIDAT E PËRBASHKËTA

Duke u bazuar në konsideratat e mësipërme, si dhe pas konsultimeve të gjera me organet qeveritare në vendet përfituese, QRA/KPQ ka filluar implementimin e aktiviteteve të mëposhtme:

A. Prokurimi i Gjellbër Publik udhënzimet dhe projekti pilot në Malin e Zi

Udhëzuesit e politikave rajonale që adresojnë paketimin plastik një përdorimësh përmes prokurimit publik aktualisht janë duke u hartuar. Këto udhëzime do të testohen përmes **një projekti pilot në Mal të Zi**, ku Ministria për Turizëm dhe Mjedis të Qëndrueshëm dhe Bashkia e Podgoricës do të zbatojnë një sërë praktikash të dakordësuara për reduktimin e mbetjeve nga paketimet plastike. Rezultatet e projektit pilot do të përdoren për të zhvilluar kritere specifike për paketimet plastike të cilat më vonë do të përfshihen në kuadrin rregullator e legjislativ.

B. Asistencë teknike, një përmbledhje e praktikave më të mira të biznesit dhe një sfidë për të mbështetur bizneset lokale në përpjekjen e tyre për të zvogëluar gjurmën e tyre mjedisore në fushën e paketimit plastik do të zhvillohet në të tre vendet


Projekti ka identifikuar përpunuesit e UP-ve, shitësit me pakicë dhe shitësit me shumicë, sektorin e shërbimeve ushqimore (hotele, bare, restorante) dhe organizatat të cilat mbështesin biznesin si audiencë kryesore për shkak të aftësisë së tyre për të shkaktuar ndryshime në të gjithë zinxhirin e sektorit të paketimit plastik nga momenti i prodhimit deri në momentin që ato shëndërohen në mbetje. Kompanitë në të tre vendet

janë identifikuar dhe janë anketuar për të vlerësuar interesin e tyre **për fillimin ose pjesëmarrjen në angazhime vullnetare** për reduktimin e përdorimit të paketimeve plastike dhe materialave plastike. Gjetjet nga anketimet do të identifikojnë **asistencën teknike** që projekti do t'u japë kompanive të interesuara për të përcaktuar dhe aplikuar angazhimin e tyre vullnetar në reduktimin e paketimit plastik. Asistenca teknike do të shërbejë si frymëzim për biznese të tjera pasi aktualisht po zhvillohet edhe një konkurs për **praktikat e mira të bizneseve për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve** nga paketimet plastike. Në përfundim, QRA/KPQ në bashkëpunim me InnovationNest, kohët e fundit ka nisur dhe një sfidë biznesi **'Cmimi për Paketimin më Mjedisor'** që synon

të identifikojë dhe komercializojë zgjidhjet ekzistuese dhe të reja të qëndrueshme për paketimin e UP-ve në vendet e projektit. Fituesi do të përfshihet në një program 4-mujor i cili do të shërbejë si inkubator biznesi dhe do të ofrohet support i dedikuar dhe burime.

C. Seminar (workshop) në nivel kombëtar

Në secilin vend do të organizohet një **seminar kombëtar** për të prezantuar progresin e projektit, për të angazhuar më tej bizneset lokale në sektorin e UP-ve për tu përfshirë në mënyrë vullnetare në reduktimin e paketimeve plastike dhe për të nxitur dialogun midis aktorëve në sektorin e UP-ve që në fazën e prodhimit të paktimit deri në momentin e kthimit të tij në mbetje.



KAPITULLI 2

GJETJET KRYESORE NGA
ANALIZA E RRJEDHËS
SË MATERIALIT
DHE RISHIKIMI I
LEGJISLACIONIT NË
SHQIPËRI, BOSNJE
DHE HERCEGOVINË DHE
MALIN E ZI



2.1. SHQIPËRIA

Me më shumë se 3,500 kompani të regjistruara në sektorin e UP-ve dhe një qarkullim prej më shumë se 400 milion Euro në vitin 2018, Shqipëria ka **industrinë më të madhe të UP-ve ndër tre vendet e projektit**. Pavarësisht këtyre të dhënave, Shqipëria ende **importon më shumë produkte të UP-ve** sesa ato që eksporton (raporti mesatar i importit / eksportit mesatar është 4). Shqipëria ka gjithashtu **numrin më të lartë të prodhuesve dhe ricikluesve të plastikës**, me afro 200 kompani të regjistruara në vitin 2018.


Referuar ARrM-së¹¹, 130,000 ton PPUP vlerësohet të hidhen në treg (HT) çdo vit në Shqipëri, 36% e të cilave si mallra të importuara të UP-ve (viti bazë, 2018). **1 në 3 nga këto PPUP përfundon në një vend depozitim të pakontrolluar ose direkte në mjedis, sasi e cila afërsisht është 40,000 ton PPUP e hedhur në treg në vit.**

65% e PPUP-ve të hedhura në treg grumbullohet nga një sistem i grumbullimit të mbetjeve në mënyrë të përzierë të cilat kryesisht depozitohen në vend **depozitime të kontrolluara dhe në landfile sanitare** pa asnjë trajtim të mëtejshëm. Grumbullimi i mbetjeve është përmirësuar në pjesën më të madhe të qyteteve gjatë dekadave të kaluara: vend depozitimet ilegale janë

mbyllur në mënyrë progresive dhe aktualisht operojnë vetëm vend depozitimet e kontrolluara, landfillet dhe një incinerator. Pavarësisht progresit të kryer, në një pjesë të konsiderueshme të zonave rurale ende mungon sistemi i grumbullimit të mbetjeve dhe në asnjë bashki aktualisht nuk është implementuar ndarja e mbetjeve në burim, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme kryhet kryesisht nga **Sektori Informal i Riciklimit (SIR)**, i cili në Shqipëri është veçanërisht i rëndësishëm pasi përfshin kryesisht Komunitetin Rom dhe në total përllogariten rreth 12,000 persona të cilët anagazhohen në këtë sektor. Ndër fraksionet e mbetjeve të riciklueshme të cilat grumbullohen më së shumti janë shishet plastike PET të cilat grumbullohen pjesërisht nga sektori informal të cilët më pas ja shesin këtë material kompanive të riciklimit me një çmim shpesh herë më të ulët se çmimi i tregut. Disa kompani riciklimi kanë grumbulluesit e tyre, të cilët janë të deklaruar. Mungojnë të dhëna të sakta për llojin dhe cilësinë e mbetjeve të grumbulluara gjë e cila pengon më tej aftësinë, e cila aktualisht është e ulët, e autoriteteve dhe institucioneve përkatëse për të ngritur dhe stabilizuar një sistem zyrtar për të dhënat nga sektori i riciklimit.

11. Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM) aktualisht po zbaton një projekt për statistikat e mbetjeve, bazuar në VKM Nr. 687, datë 10.11.2017, mbi Statistikat e Mbetjeve, i cili pritet të masë me saktësi sasinë e mbetjeve të paketimit të gjeneruara dhe ricikluara.

Paraqitje e thjeshtuar e rezultateve të Analizës së Rrjedhës së Materialit në Shqipëri. (Vlerësimet e autorit. Viti bazë: 2018)



Në Shqipëri, **menaxhimi i mbetjeve aktualisht konsiderohet të jetë problemi më urgjent mjedisor**. Implementimi i një kuadri të përshtatshëm politikash, krijimi i një infrastrukture adekuate dhe ngritja e kapaciteteve institucionale nuk kanë arritur të mbajnë ritmin me rritjen ekonomike dhe shtrirjen urbane të përjetuar nga Shqipëria gjatë dekadave të fundit. **Me gjithë përpjekjen e Qeverisë Shqiptare për të transpozuar 19 direktiva dhe rregullore të BE-së të lidhura me mbetjet, plotësisht ose pjesërisht, deri në fund të vitit 2015, implementimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve të reja në masën më të madhe, mbetet prapa.** Arsyeja kryesisht qëndron në mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, kjo e fundit rrjedh kryesisht nga mungesa e një sistemi kostoje dhe tarife e cila të jetë gjithëpërfshirëse dhe e bazuar në kostot reale të shërbimit. Ky fakt pengon seriozisht vullnetin politik për të investuar më tej në një sistem eficient të menaxhimit të mbetjeve.

Referuar Analizës së Legjislacionit, Shqipëria ka tashmë akte të mjaftueshme legjislative, siç janë përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit (PZP) ose ndarja e mbetjeve në burim, për të adresuar menaxhimin e mbetjeve të PPUP-së (shih në mënyrë më të hollesishme tabelën e përmbledhjeve më poshtë Kapitulli 3). Këto akte kërkojnë thjesht të zbatohen. **Vlerësohet se zbatimi i legjislacionit ekzistues duhet të ketë më shumë përparësi sesa implementimi i masave të reja.** Që kjo të ndodhë, duhet të ngrihen kapacitetet (d.m.th., personel të aftë, infrastrukturë dhe sisteme monitorimi) dhe duhet të ndërmerren veprime për të adresuar shkallën e lartë të informalitetit që karakterizon ekonominë Shqiptare, gjë që e bën aplikimin e masave ekzistuese shumë të pasuksesshme.

Një skemë kombëtare PZP e hartuar mirë dhe e zbatuar në mënyrën e duhur ka potencialin për të përmirësuar grumbullimin, trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve të paketimit (plastik), pakësimin e sasisë së ambalazhit të depozituar dhe kontribuar në zhvillimin e një tregu për lëndë të parë me cilësi të lartë (skrap plastik). Që kjo të ndodhë,

të gjithë aktorët e përfshirë në këtë sektor, nga prodhuesit deri tek ricikluesit, duhet të angazhohen dhe të bashkëpunojnë në hartimin e një skeme të përshtatshme PZP. Sektori informal gjithashtu duhet të përfshihet në mënyrë aktive që në fazat e para të zbatimit të skemës, grumbulluesit informalë duhet të regjistrohen, profesionalizohen dhe të angazhohen në sistemin e raportimit.

Për të nxitur investimet dhe inovacionin në sektorin e biznesit, Qeveria Shqiptare mund të adoptojë praktika të **Prokurimit të Gjelbër Publik** dhe / ose të ndihmojë në identifikimin e sinergjive midis zinxhirëve / hallkave të furnizuesve (privat dhe publik) dhe autoriteteve përkatëse lokale (të tilla si departamentet e qeverisë qendrore, autoritetet lokale dhe dhomat e tregtisë) për të inkurajuar përdorimin e nënprodukteve (copëza plastike) si lëndë të parë për tu përpunuar në zinxhirët e prodhimit dhe furnizimit, duke favorizuar kalimin drejt një ekonomie më të qëndrueshme, qarkulluese dhe duke zvogëluar përdorimin e burimeve të papërdorura / të virgjëra, emetimet e karbonit dhe gjenerimin e mbetjeve. Autoritetet lokale mund të inkurajojnë këtë tranzicion duke ndërmarrë lehtësime fiskale për këto biznese që ndërmarrin të tilla nisma. Shembuj të këtyre qasjeve përfshijnë krijimin e **parqeve eko-industriale** të përshtatshme për rikuperimin e materialeve dhe politikat e përjashtimit nga taksat për kompanitë e përfshira në këto aktivitete për rikuperimin e materialit.

Në përfundim, deri më tani nuk ka dispozita ligjore dhe rregullore që adresojnë posaçërisht **Kërkimin dhe Zhvillimin si dhe hulumtimin publik mbi paketimin e UP-ve**. Shqipëria gëzon një mbështetje të gjerë financiare dhe teknike nga donatorët, të tillë si Bashkëpunimi për Zhvillimi, Austriak dhe Suedez, GIZ-i Gjerman dhe të tjerë, të cilët mund të drejtohen për të nxitur kërkimin publik-privat dhe K&Zh për të zhvilluar alternativa të shëndosha mjedisore për paketimet nga UP-et ose praktikat më të mira të biznesit në drejtim të prodhimit me zero plastikë.





2.2. BOSNJE DHE HERCEGOVINA

Bosnje dhe Hercegovina (BH) ka një **sektor të UP-ve të orientuar drejt tregut të brendshëm** e relativisht të vogël, me 398 kompani të regjistruara në të cilat janë të punësuar rreth 5 000 punëtorë kryesisht në sektorin e brumërave, bukës dhe ëmbëlsirave. Shitjet në vend realizohen kryesisht përmes dyqaneve/supermarketeve të mëdha (p.sh., Konzum, Mercator, Hoše, Bingo, Amko, Peni, Tropic). **Mallrat e UP-ve importohen kryesisht nga vendet fqinje**, ndërsa eksportet janë të kufizuara nga pengesat legjislative dhe niveli i ulët i konkurrencës¹². **Paketimi plastik në sektorin e UP-ve (PPUP) gjithashtu importohet**: vetëm 9 kompani vendase prodhojnë paketim plastik për produktet e UP-ve dhe ato nuk përdorin materialin e ricikluar në vend, pasi të dy fabrikat e riciklimit në BH prodhojnë materiale plastike jo të përshtatshme për përdorime në sektorin e UP-ve.

Referuar gjetjeve të ARrM-së, përafërsisht 121,000 tonë plastikë të lidhura me PPUP-në (përfshirë peletat dhe materialin e ricikluar të përdorur për prodhimin e ambalazheve

plastike, mallrat e UP-ve dhe PPUP) hyjnë në BH çdo vit, nga të cilat përafërsisht 7,600 ton eksportohen si produkte të UP-ve dhe materiale të riciklueshme (një pjesë e vogël), ndërsa rreth 110,000 ton PPUP vlerësohen të hidhen në treg (HT) si PPUP për konsum dhe jo-konsum çdo vit (viti bazë, 2017). Përafërsisht 26,000 ton (23% e PPUP e HT) përfundojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mjedis (hidhen në mënyrë ilegale) ose në vend depozitime. Ndërsa 84,700 ton (77% e PPUP e HT) grumbullohet dhe 98% e kësaj sasive përfundon në lëndfill. Është për t'u theksuar se 92% e lëndfilleve të regjistruara në BH nuk përmbushin standardet. Përafërsisht 5% e mbetjeve të PPUP-së (mbetjet bashkiake dhe rrymat e grumbulluara në mënyrë të diferencuar) trajtohen (në 4 objekte të ndarjes së mbetjeve) nga të cilat vetëm 1.18% ose 1,300 ton/vit riciklohen, duke detyruar kompanitë ekzistuese të riciklimit (dy kompani të regjistruara në BH) të importojnë mbetje plastike nga vendet fqinje për të mbajtur kompanitë e tyre operative.

12. Në 2017, raporti mesatar i importit / eksportit për BH ishte 7, dhe 66% e paketimeve plastike UP-ve të hedhur në treg vinin nga mallrat e importuara të UP-ve.

Paraqitje e thjeshtuar e rezultateve të Analizës së Rrjedhjes së Materialeve në BH. (Vlerësimet e autorit. Viti bazë: 2018)



Këto gjetje kërkojnë adresim të menjëhershëm nëpërmjet politikave të cilat duhet të implementohen për parandalimin e mbetjeve të PPUP dhe përmirësimin e sektorit të menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe entiteti.

Që prej vitit 2011, Bosnje Hercegovina ka përparuar në mënyrë të vazhdueshme në harmonizimin e kuadrit të saj legjislativ me atë të BE-së, në lidhje me politikën dhe strategjitë e lidhura me paketimin plastik, siç tregohet edhe në tabelën përmbledhëse në Kapitullin 3. Sidoqoftë, **një qeveri shumë e decentralizuar ka penguar koordinimin e politikave dhe reformave duke e lënë kuadrin e politikave në lidhje me paketimin plastik të fragmentuar dhe pa pushtet ekzekutiv**. Burokracia e tepërt dhe një treg i segmentuar dekurajojnë bashkëpunimin midis palëve të interesuara përgjatë zinxhirit të sektorit, që në momentin e prodhimit të PPUP-së deri në momentin që ato kthehen në mbetje, ndërkohë që ndërgjegjësimi i pakët dhe angazhimi i vogël i konsumatorëve (kryesisht familjet dhe sektori i shërbimeve ushqimore) për parandalimin ose reduktimin e paketimeve plastike në baza vullnetare parandalojnë më tej reformat e nevojshme.

Megjithatë, ekzistojnë **mundësi** interesante dhe duhet të konsiderohen me kujdes nga prodhuesit vendas të UP-ve për të përparuar seriozisht drejt një sektori më cirkular, ku paketimet plastike të mos përdoren më në sektorin e UP-ve. Një kërkesë e rëndësishme e tregut vendas për prodhime lokale "tradicionale", afërsia me tregjet lokale, njohja e sjelljes së konsumatorit i bënë kompanitë lokale të UP-ve kandidat të mirë për tu bërë kampionë në parandalimin / reduktimin e paketimeve plastike.

Zhvillimi i alternativave të qëndrueshme, miratimi i masave parandaluese të PP ose praktikave të prodhimit me efikasitet të lartë dhe më miqësore me mjedisin mund të **kthehen në avantazh për bizneset lokale dhe të hapin mundësi të reja në nivel rajonal dhe kundrejt vendeve të BE-së**.

Qeveritë në nivel kombëtar dhe në nivel entiteti kanë gjithashtu mundësinë për të forcuar **kuadrin e tyre politik / ligjor** duke kryer:

- ♦ Harmonizimin e bazës së të dhënave për mbetjet nga paketimet dhe sistemin e raportimit / monitorimit me EUROSTAT, përmirësimin e koordinimit midis të gjithë aktorëve përkatës përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor që nga prodhimi deri në momentin e kthimit në mbetje të produktit dhe vënien në dispozicion të publikut të të dhënave kyçe,
- ♦ promovimin e krijimit të shoqatave të prodhuesve të PP-ke, ndoshta duke ndërtuar mbi grupin ekzistues të prodhuesve plastikë

në BH për të ndihmuar në monitorimin e të dhënave të prodhimit, kërkesës, tregtisë, riciklimit dhe rikuperimit,

- ♦ përcaktimin e objektivave më ambicioz në lidhje me riciklimin, parandalimit të mbetjeve të PP-ve dhe kërkesat e eko-projektimit
- ♦ forcimi i kuadrit legjislativ për skemat ekzistuese të PZP-së, duke ndjekur shembujt e skemave më të avancuara të vendeve të BE-së për të kërkuar nga OPP-të nivele më të larta të grumbullimit dhe në këtë mënyrë nxitjen e ndarjes në burim, në shtëpi, të mbetjeve nga UP (veçanërisht të PET për të siguruar një fluks të qëndrueshëm për të ushqyer biznesin lokal të riciklimit) dhe inkurajon veprimet të lidhura me parandalimin ose ripërdorimin e PP,
- ♦ zgjerimi, rishikimi dhe përmirësimin e Dekretit¹³ për tarifën e qeseve plastike për të siguruar rezultate pozitive në nivel entiteti / kombëtar. Implementimi i tarifave për qeset plastike në 2014 në BH në të vërtetë ka ulur konsumin e qeseve plastike (nga 9.3 milion në vitin 2014 në 3.5 milion në 2017) por ky rezultat pozitiv u ngadalësua nga një rritje e përgjithshme e qeseve plastike të hedhura në treg të cilat nuk i nënshtrohen Dekretit (nga 66.4 milion në 69.9 milion në 2017),
- ♦ duke u zgjeruar në të gjitha asortimentet e PPUP-ve të përshtatshme dhe zyrtarizimin e Sistemit të Kthimit të Depozitave që aktualisht përdoret nga sektori privat për shishet e qelqit, si pjesë ose në koordinim të ngushtë me skemat PZP dhe me angazhimin e plotë të sektorit informal,
- ♦ duke i mundësuar biznesit njohuritë e duhura dhe mundësi financiare për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve brenda kompanisë së tyre dhe zhvillimin e praktikave parandaluese të PP-ve përmes angazhimit aktiv të universiteteve, organizatave të cilat mbështesin biznesin dhe institucioneve financiare,
- ♦ zbatimit të rregulloreve ekzistuese,
- ♦ duke parë mundësitë e Prokurimit të Gjellbër Publik për të frenuar gjenerimin e mbetjeve të PPUP-së në institucionet publike (p.sh. në godinat e administratës, shkollat, etj),
- ♦ përkrahja e iniciativave vullnetare për të promovuar paketime alternative me paketimet plastike

13. Dekreti për Tarifën për ndalimin e tregtimit të qeseve plastike me doreza mbajtëse (FZ e Federata e Bosnje Hercegovinës, Nr. 09/14), për të cilat duhet paguar një tarifë prej 0.025 EUR për një, cope, qese plastike (deri në 20 mikron) të hedhur në treg që nga viti 2014.



2.3. MALI I ZI


Me një popullsi prej rreth 600,000 banorë Mali i Zi ka një **sektor relativisht të vogël të prodhimit të UP-ve**, duke prodhuar kryesisht birrë, pije alkoolike (verë), nën produkte të qumështit dhe mish. **Shumica e mallrave të UP-ve importohen**: në vitin 2017, importi i ushqimit dhe kafshëve të gjalla ishte 16 herë më i lartë se eksporti dhe për pijet dhe duhanin rreth 3 herë më i lartë. **Pak kompani janë regjistruar sot për prodhimin dhe shpërndarjen e paketimeve plastike të cilat kryesisht prodhojnë qese plastike**. Në Podgoricë, ekzistojnë pesë 'oborre riciklimi' dhe një qendër riciklimi, të cilat janë pranuar pozitivisht nga qytetarët. Nëpërmjet këtyre metodave grumbullimi i diferencuar i mbetjeve në qytet po rritet dita ditës. Mbetjet e diferencuara pranohen aktualisht nga kompanitë vendase të cilat organizojnë grumbullimin, transportin, depozitimimin e përkohshëm dhe depozitimimin përfundimtar të të gjitha llojeve të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, si dhe kryejnë eksportin e këtij materiali. Pavarësisht nga madhësia e kufizuar e vendit, **ekzistojnë disa shoqata brenda Dhomës së Tregtisë dhe ofrojnë kushtet ideale për dialog dhe bashkëpunim midis të gjitha palëve të interesuara në sektorin PPUP-ve** (d.m.th., Shoqata për Ekonomi Bashkiake, Shoqata e Bujqësisë dhe Industrisë Ushqimore, Shoqata e Tregtisë dhe Shoqata e Ndërmarrjeve të Vogëla e të Mesme dhe Sipërmarrësit).

Kryerja e Analizës së Rrjedhës së Materialit për sektorin e PPUP në Malin e Zi ishte një **nismë teëpër sfiduese për shkak të mungesës sistematike të të dhënave të besueshme të PPUP-ve si në fazën e prodhimit, tregtisë dhe menaxhimit të mbetjeve**. Një Rregullore për metodologjinë e përcaktimit të përbërjes dhe sasisë së mbetjeve bashkiake në territorin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ("Në Fletoren Zyrtare të Malit të Zi", Nr. 025/18 në 20.04.2018) e cila u botua në vitin 2013 dhe u bë aktive në vitin 2018, përfshirë një Katalog të Mbetjeve në përputhje me Katalogun e Mbetjeve të BE-së. Megjithatë, **nw Mal tw Zi nuk ekziston një bazë e tw dhënave e përshtatshme për mbetjet**. Ky fakt njihet gjerësisht nga palët e interesit si një nga problemet më të rëndësishme që hasin gjatë fazës së planifikimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Malin e Zi.

Referuar gjetjeve të ARrM-së, vlerësohet se 21,000 ton janë hedhur në treg (HT) si PPUP për konsum dhe jo-konsum çdo vit, 35% e të cilave si mallra të importuara në sektorin e UP-ve. Përafërsisht 2,300 tonë (11% e PPUP e HT) përfundojnë direkt në mjedis ose në vend depozitime ilegale, ndërsa pjesa tjetër 89% (18,690 ton / vit) grumbullohen dhe përfundojnë kryesisht në landfille (80% e PPUP-ve të grumbulluara). Përafërsisht 27% e PPUP HT ndahet në mënyrë mekanike, nga të cilat një sasi e papërfillshme (140 ton / vit) riciklohet.

Paraqitja e thjeshtuar e rezultateve të Analizës së Rrjedhjes së Materialit në Mal të Zi.

(Vlerësimet e autorit. Viti bazë: 2018)



Si një vend kandidat për në BE, Mali i Zi po intensivon përpjekjet për të përafruar standardet e tij mjedisore dhe kuadrin ligjor me Acquis mjedisor të BE-së, siç përshkruhet në tabelën përmbledhëse në Kapitullin 3.

Strategjia Kombëtare së bashku me Planin e Veprimit për Transpozimin, Implementimin dhe Zbatimin e Acquis të BE-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike 2016 – 2020

Është dokumenti referencë që përshkruan detyrimet e Malit të Zi. Sipas Strategjisë, deri më tani janë transpozuar në pjesën më të madhe, Direktiva 2008/89 / EU (Direktiva për Menaxhimin e Mbetjeve) si dhe Direktiva 94/62 / EU (Për Paketimet dhe Mbetjet nga Paketimet). Transpozimi i plotë i Acquis i BE-së në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë përmbushjen e detyrimeve siç janë dhe investimet në infrastrukturë, janë planifikuar për vitin 2035.

Një nga detyrat më urgjente të Malit të Zi është të përmirësojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

Në këtë drejtim, përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit (PZP) dhe Sistemi i Kthimit të Depozitave (SKD) janë masa të cilat kanë rezultuar efektive në disa vende të BE-së. Ligji i vitit 2016 për menaxhimin e mbetjeve (LMM)¹⁴ parashikon krijimin e një skeme kombëtare të PZP-së. Megjithatë, për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe dispozitave të pa zbatueshme, skema aktualisht nuk është implementuar dhe zbatuar. Duhet të zhvillohet dhe zbatohet një kuadër i duhur rregullator për të siguruar gjithë-zbatueshmërinë dhe për të shmangur mbivendosjet dhe konfliktet e interesit. Duhet të përcaktohen objektivat të qarta, realiste (për riciklimin) si dhe zhvillohet dhe zbatohet një sistem monitorimi transparent dhe i përgjegjshëm dhe përgjegjësitetë të ndahen qartë midis palëve të interesit. Për të shmangur kundravajtjet (psh. importet nga vendet ilegale nga vendet fqinje) duhet të sigurohet kontrolli dhe zbatimi i PZP-së nga të gjithë.

Në vijim, skema PZP-ë mund të funksionojë në kombinim me masa të tjera si:

- ◇ Skema, paguaj aq sa hedh, me të cilën familjet tarifoën bazuar në sasinë

e mbetjeve që ato gjenerojnë. Këto skema mund të stimulojnë familjet për të kryer ndarjen e mbetjeve për riciklim, duke ndihmuar kështu grumbullimin e diferencuar dhe lehtësuar funksionimin e PZP-së;

- ◇ Instrumentet e bazuara në treg, siç janë taksat, gjithashtu mund të aplikohen në mënyrë të kombinuar me/për të promovuar skemën PZP;
- ◇ Sistemi i Kthimit të Depozitës - pas implementimit të suksesshëm të SKD-së për shishet e qelqit, të Birrës “Trebjesa ad”, mund të integrohet në skemën kombëtare PZP për të siguruar një material plastik të pastër dhe cilësor për riciklimin. Është me rëndësi gjithashtu që sasia e plastikës e përfutur nga ky proces të shkojë për furnizimin e kompanive vendase të riciklimit ose në rast të kundërt të eksportohet. Sot, nga 25% e mbetjeve të PPUP-ve të ndara mekanikisht, vetëm 2% riciklohen në vend: ka me të vërtetë një nevojë urgjente për të zgjeruar kapacitetin e riciklimit të plastikës në vend.



14. Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM) “Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 064/11 nga 29.12.2011 dhe 039/16 nga 29.06.2016.

Në pjesën e **parandalimit të gjenerimit të mbetjeve të PPUP-së**, skema kombëtare PZP mund të hartohet për të inkurajuar parandalimin e gjenerimit ose ripërdorimin, më shumë se sa të përqendrohet ekskluzivisht në menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve (për shembull përmes eko-modulimit të tarifave). Më tej, programi “Le të blejmë produkte lokale” i Qeverisë në mbështetje të prodhimeve vendase të UP-ve mund të ri-dizajnohet për të rritur prodhimin e mallrave lokale të UP-ve pa përdorur paketim plastik. Me një prodhim të brendshëm jashtëzakonisht të kufizuar të plastikës, kalimi në paketime pa plastikë mund të jetë më i lehtë sesa në vendet e tjera. Prokurimi i Gjellbër Publik i hartuar mirë mund të lehtësojë më tej këtë tranzicion.

Mali i Zi mund të përdorë disa mundësi financimi të mundësuar nga BE (të tilla si Programi tranzitor i Danubit dhe Programi Ndër-rajonal Adrion) për:

- ◇ stimulimin K&ZH në paketimet alternative në sektorin e UP-ve;
- ◇ trajnimi dhe formimi i bizneseve lokale të UP-ve për të qënë më eficiente dhe miqësore me mjedisin;
- ◇ rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët dhe turistët për çështjen e mbetjeve detare me fokus plastikën dhe nevojën për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve nga paketimet plastike;
- ◇ trajnimin e autoriteteve dhe institucioneve përkatëse përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve



KAPITULLI 3
ANALIZA E
LEGJISLACIONIT
FISHA PËRMBLEDHËSE

Fishat e mëposhtme të vendit përshkruajnë gjetjet kryesore nga analiza e legjislacionit. Instrumente të ndryshme të politikave përshkruhen për sa i përket strategjive të miratuara, ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat përmbajnë një kod ngjyrash:

- Nuk është e rregulluar
- Rregulloret janë miratuar por nuk janë zbatuar plotësisht për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera

Për secilin instrument përshkruhen përparimi në zbatim, si dhe sfidat dhe mundësitë.



Objektivat e Riciklimit

- **Strategji, ligje dhe akte nën ligjore**
NUK KA NJË RREGULLORE

Rregullimi i Menaxhimit të Mbetjeve

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji nr. 10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" datë 22.09.2011

VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për ndarjen e mbetjeve në burim"

VKM. nr. 452/2012 nr. "Për Lendfilllet"

VKM. nr. 178/2012 ' Për inceneratorët "

Aktet nënligjore për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim (VKM. 408, 25 qershor 2008)

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Plani Kombëtar i Rishikuar i Menaxhimit të Mbetjeve 2018-33)

Planet Rajonale të Menaxhimit të mbetjeve

Progresi

Legjislacioni për grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe për trajtimin përfundimtar të mbetjeve është i përgjithshëm.

Objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve janë paraqitur më poshtë:

- ◇ 85% e familjeve në vitin 2020 do të marrin një shërbim të përshtatshëm përsa i përket

sistemit të grumbullimit të mbetjeve, dhe 90% e tyre në vitin 2025;

- ◇ Sasia e trajtuar e mbetjeve në lendfill duhet të shkojë deri në 45% deri në 2020 dhe 70% e mbetjeve do të riciklohet nëpërmjet sistemeve të riciklimit, kompostimit dhe nëpërmjet rikuperimit të energjisë.

- ◇ Deri në vitin 2015 ndarja e mbetjeve në burim duhet të kryhet për të paktën këto rryma mbetjesh: letër/karton, metal, plastik dhe qelq;

- ◇ Deri në vitin 2020 zvogëlimi i sasisë së gjeneruar të mbetjeve në rang vendi.

- ◇ Deri në vitin 2015: të arrihet niveli 25% i riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve bashkiake (deri në vitin 2020: 55%);

- ◇ Rikuperimi i energjisë nga të paktën 15% e mbetjeve bashkiake të gjenruara në vend;

- ◇ Zvogëlimi i sasisë së mbetjeve të depozituara në landfill nga 90% deri në 30% deri në vitin 2025;

- ◇ Ofrimi i asistencës ndaj bizneseve për mënyrat e parandalimit të gjenerimit të mbetjeve;

- ◇ Zhvillimi i tregjeve për materialin e ricikluar;

- ◇ Trajtimi i mbetjeve në mënyrë më të qëndrueshme dhe përdorimi eficient i resurseve;

Referuar Strategjisë Kombëtare

- ◇ Cdo Qark është përgjegjës për hartimin

e Planit të vet Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve.

◇ Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të mbetjeve, transportin dhe depozitimin, dhe menaxhimin e kontratave me kompanitë që kryejnë pastrimin e qyteteve, përfshirë investimet e mbetjeve në nivelin lokal.

Sfida dhe Mundësi

◇ Nga moment i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10463 është arritur përparim i ndjeshëm në menaxhimin e mbetjeve. Autoritetet lokale janë të detyruara të organizojnë

grumbullimin e mbetjeve të ngurta bashkiake (MNB) dhe të sigurojë të dhëna organeve përkatëse të Qeverisë. Shumica e zonave urbane tani kanë një sistem të grumbullimit të MNB, ndërsa zonat një pjesë e zonave rurale nuk janë ende të mbuluara.

◇ Planet Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve janë hartuar në disa rajone, por ende nuk janë aprovuar pasi presin që më parë të miratohet Plani i Rishikuar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Rregullimi i Menaxhimit të mbetjeve nga paketimi

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

VKM nr. 418/2014 "Për ndarjen e mbetjeve në burim"

VKM nr. 177/2012 'Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre'

VKM nr. 232, datë 26.4.2018 "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 177, datë 6.3.2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet".

VKM nr. 608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve organike si dhe kriteret dhe afatet për reduktimin e tyre'

Ligj nr.9983, datë 28.1.08 i ndryshuar më 26.03.2013

Progresi

◇ VKM nr. 418/2014 përcakton masat për alokimin e burimeve për reduktimin e sasisë së mbetjeve të cilat depozitohen në lëndfill.

◇ VKM nr. 177/2012 është në linjë me

legjislacionin e EU dhe direktivën kuadër për mbetjet duke synuar riciklimin e mbetjeve nga ambalazhet.

◇ Referuar ligjit nr.10463 / 2011, NJQV-të janë përgjegjëse për organizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve nga ambalazhet. Deri më 31 dhjetor të vitit 2020, çdo NJQV duhet të arrijë objektivin e:

◇ të paktën 50% të peshës totale të mbetjeve organike të gjeneruara në vitin 2014

◇ të ripërdoren dhe riciklohen 60% të letrës / kartonit, 50% të metaleve, 22.5% të plastikës dhe 60% të qelqit

◇ VKM nr. 232/2018, përveç përcaktimit të rregullave për parandalimin e dëmeve mjedisore nga mbetjet, detyron prodhuesit të përdorin 55-80% materiale të ricikluara në prodhimin e paketimeve dhe ndalon përdorimin e qeseve plastike të cilat nuk janë të biodegradueshme.

◇ Ligji Nr. 9863 lejon përdorimin e materialeve të ricikluara në industrinë e UP-ve. Pjestarët e industrisë së UP-ve, prodhuesit, importuesit dhe shitësit e mallrave të paketuara duhet të rikuperojnë dhe riciklojnë të paktën 8% të sasisë së paketimit deri në vitin 2019.

Sasia do të rritet për të arritur të paktën 39% deri në vitin 2033. Bashkitë, nga ana tjetër, janë përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe ndarjen e tyre në dy rryma: mbetje të riciklueshme dhe mbetje të përziera. Deri në vitin 2033, bashkitët duhet të riciklojnë deri në 50% të mbetjeve urbane të gjeneruara.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Pavarësisht legjislacionit ekzistues, ndarja e mbetjeve në burim nuk është zbatuar ende.
- ◇ Shqipëria nuk ka një legjislacion specifik për materialet të cilat kanë kontakt me ushqimin. Siguria ushqimore adresohet në Ligjin nr.9863/ 28.01.2008 ' Për ushqimin.

Përgjegjësia e Zgjerruar e Prodhuesit (PZP)

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Plani Kombëtar i Rishikuar i Menaxhimit të Mbetjeve 2018-33)

Statusi

Neni 16 i Ligjit nr.10 463 parashikon se PZP-ja do të përcaktohet nga nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

Sipas Strategjisë Kombëtare deri në vitin 2023:

- ◇ Duhet të jetë krijuar një kornizë rregullatore për krijimin e skemave të grumbullimit dhe riciklimin të ambalazhit
- ◇ Të gjitha bizneset që importojnë dhe prodhojnë ambalazhe, raportojnë sasinë e importit dhe prodhimit tek autoritetet përkatëse dhe krijojnë skema specifike dhe / ose të përbashkëta në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor dhe përdoruesit e tjerë të ambalazheve për të rikuperuar ambalazhin.
- ◇ Këto skema grumbullojnë dhe riciklojnë jo më pak se 8% të sasisë totale të ambalazheve

deri në vitin 2028:

- ◇ Prodhuesi i Mallrave të Ambalazuara dhe Prodhuesi i Ambalazhit që mbushin produktet e tyre në pikën e shitjes ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre, mbledhin dhe financojnë të gjithë skemën e grumbullimit dhe trajtimit të integruar të tyre vetë ose nëpërmjet Organizatave të Përgjesisë së Zgjerruar të Prodhuesit.

- ◇ Këto skema mbledhin dhe riciklojnë jo më pak se 21% të sasisë së ambalazhit

deri në vitin 2033:

- ◇ Prodhuesi i Mallrave të Ambalazuara dhe Prodhuesi i Ambalazhit që mbushin produktet e tyre në pikën e shitjes ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre rikuperojnë dhe riciklojnë 39% të sasisë së ambalazhit në vend, vetë ose nëpërmjet Organizatave të Përgjesisë së Zgjerruar të Prodhuesit.

- ◇ Një sistem takse aplikohet për a mbalazhet e plastikës dhe qelqit (shiko Ligjin Nr. 178, datë 28.12.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008," Për Taksat Kombëtare")

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Implementimi i PZP kërkon aprovimin e akteve nën ligjore si dhe vendosjen e zbatimit e rregullave të qarta për parandalimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve nga ambalazhi dhe marrjen përsipër të kostove financiare për këto aktivitete. Deri më tani në Shqipëri nuk zbatohet asnjë skemë PZP.

- ◇ Nuk ka grumbullim të diferencuar të ambalazheve me qëllim zbatimin e parimeve të mbrojtjes së mjedisit.

Sistemi i Depozitës së Ambalazhit

- **Strategji, ligje dhe akte nën ligjore**
NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Incentiva Ekonomik Shkurajues

● **Strategji, ligje dhe akte nën ligjore**

VKM Nr.177 datë 06.03.2012 ' Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre'

Statusi

- ◇ VKM Nr. 177 ka pëfshirë tarifa për prodhuesit dhe importuesit për mbetjet nga ambalazhi.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ VKM Nr. 177 mund të ketë nevojë të përmirësohet duke parashikuar tarifa për kompanitë që nuk përdorin materiale të ricikluara në procesin e tyre të prodhimit.

Incentiva Ekonomik

● **Strategji, ligje dhe akte nën ligjore**

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Nuk ka skema stimuluese për prodhuesit dhe ricikluesit.

Ndalim për produktet me impakt negativ në mjedis

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

VKM Nr. 232, datë 26.04.2018 'Për ndalimin e qeseve plastike jo të biodegradueshme'

Statusi

◇ VKM nr. 232, datë 26.4.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 177, datë 6.3.2012 ka ndaluar përdorimin e qeseve plastike një përdorimshe dhe të pa biodegradueshme

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Vetëm qeset plastike jo të biodegradueshme janë ndaluar me VKM Nr. 232, datë 26.04.2018
- ◇ Sidoqoftë, konceptet e gabuara të biodegradueshmërisë së plastikës (përfshirë plastikën të oxo degradueshme që konsiderohet si e biodegradueshme) mund të rezultojnë në keqpërdorim të etiketave të biodegradueshmërisë dhe mungesë të trajtimit të diferencuar të mbetjeve.

Eko Etiketa

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

VKM nr. 177, datë 6.3.2012 'Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre'

VKM nr. 434, datë 11.07.2018 për "Etiketimin e Ushqimit dhe Informacionin e Konsumatorit"

Status

- ◇ VKM nr. 434 përcakton që i gjithë ambalazhi i ushqimit duhet të sigurojë informacione nëse ato mund të riciklohen dhe / ose nëse janë të biodegradueshme.

Prokurimi i Gjellbër Publik

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Green Public Procurement (GPP)

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Që Prokurimi Publik i Gjellbër të zbatohet, kërkohet aprovimi i legjislacionit shtesë për të përcaktuar praktikën e gjellbërta.

3.2. BOSNJE DHE HERCEGOVINA

Nuk ekziston asnjë politikë apo rregullore në mbarë vendin e lidhur me menaxhimin e mbetjeve në BH. Meqenëse mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i mbetjeve, është nën juridiksionin e njësisive dhe distriktit, qeveritë e njësisive FBH dhe RS dhe qeveria për RB janë përgjegjës për hartimin dhe miratimin e politikave dhe rregulloreve të tyre.

Objectivat e riciklimit

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

*Strategjia Federale e Menaxhimit të Mbetjeve (2008–18)*¹⁵

Rregullorja për menaxhimin e paketimeve dhe mbetjeve të paketimeve. (RMPMP) (F.Z Fletorja zyrtre) F.Z. e FBH, Nr. 88/11, 28/13, 08/16, 54/16, 103/16 dhe 84/17

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve F.Z. e FBH, Nr. 33/03, 72/09 dhe 92/17

REPUBLIKA E SERBISË

Strategjia e menaxhimit të mbetjeve përcakton objektivat për rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve të paketimit, por pa përcaktuar ndarjen për llojin e mbetjeve të paketimit

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM) F.Z. e RS, Nr. 111/13, 106/15 and 16/18

RAJONI BRCKO I BH

NUK KA OBJEKTIVA PËR RICIKLIMIN

Progresi

Në FBH:

- ◇ Strategjia Federale e Menaxhimit të

Mbetjeve parashikon që deri në vitin 2018 15% e paketimeve plastike të gjeneruara nga mbetjet bashkiake duhet të të mblidhen dhe riciklohen

- ◇ RMPMP Rregullorja për Menaxhimin e Paketimeve dhe Mbetjeve të Paketimeve përcakton që deri në vitin 2016, 16% e mbetjeve të paketimeve plastik të hedhura në treg duhej të rikuperoheshin ose ricikloheshin. Sipas ndryshimit të Rregullores (F.Z. e FBH, nr. 103/16), objektivat për vitin 2016 do të zbatohen për pesë vitet e ardhshme.

Në RS,

- ◇ Objektivat e riciklimit për mbetjet nga paketimet plastik janë 16% në 2017 dhe 20% në 2018.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Objektivat ekzistuese të riciklimit janë dukshëm nën nivelin e specifikuar në kuadrin legjislativ të rishikuar të BE-së për mbetjet¹⁶, duke u arritur lehtësisht nga sistemi ekzistues i grumbullimit. Objektivat në FBH mbahen të pandryshuar që në vitin 2012, ndërsa në RS nuk ekziston ndonjë dispozitë e qartë për rritjen e objektivit dhe objektivat aktuale duhet të bëhen operacional

- ◇ Shkalla e riciklimit llogaritet si mbetje e dërguar për riciklim duke përfshirë edhe mbetjet e eksportuara për qëllime riciklimi dhe jo nga sasitë faktike të ricikluara.

15. Një strategji e re është planifikuar në vitin 2019 me mbështetje financiare nga SIDA dhe ndihmë teknike të siguruar nga Agjencia Suedeze e Mjedisit.

16. Kuadri legjislativ i rishikuar për mbetjet ka hyrë në fuqi në korrik 2018, përcakton objektivat minimale sipas peshës të cilat janë paraqitur në vijim: një objektiv i përbashkët me BE-në për riciklimin e 65% të mbetjeve bashkiake deri në vitin 2035; një objektiv i përbashkët me BE-në për riciklimin e 70% të mbetjeve të paketimit deri në vitin 2030; një objektiv specifik për riciklimin e 55% të mbetjeve plastike të paketimit deri në vitin 2030.

- ◊ Në të dy entitetet, ka mungesë të ndërgjegjësimit të publikut dhe interes për grumbullimin e diferencuar si dhe nuk ka raste në të cilat biznesi është stimuluar për të kryer ndarjen e mbetjeve në burim në nivel kompanie.
- ◊ Si rezultat, impiantet e ndarjes manuale të instaluar në BH funksionojnë nën kapacitet për shkak të mungesës së fraksioneve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar të MNB-ve.

- ◊ Taksat e depozitimit në Lendfill paguhen vetëm në lëndfillet sanitare rajonale dhe janë më të ulëta se mesatarja e BE-së (12 EUR - 22 EUR për ton mbetje). Vend depozitimet jo sanitare në nivel bashkie që nuk plotësojnë standardet nuk kërkojnë pagesë për depozitimin e mbetjeve. Ky grupim nuk kontribuon në promovimin e riciklimit të mbetjeve ose në parandalimin e gjenerimit të tyre.

Rregullimi i Menaxhimit të Mbetjeve

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Strategjia Federale e Menaxhimit të Mbetjeve (2008-18)

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LWM) F.Z. e FBH, Nr. 33/03, 72/09 dhe 92/17

Rregullore për kategoritë e mbetjeve me listat përkatëse F.Z. e FBH, nr 09/05

REPUBLIKA E SERBISË

Strategjia e Menaxhimit të Mbetjeve (2017-26)

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM) F.Z. e RS, Nr 111/13, 106/15 dhe 16/18

Rregullore për kategoritë, kontrollin dhe klasifikimin e mbetjeve F.Z. e Republikës së Serbisë, Nr. 19/15 dhe 79/18

RAJONI BRCKO I BH

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve F.Z. e RB BH, nr. 25/04, 1/05, 19/07, 2/08 dhe 9/09

Rregullore për kategoritë e mbetjeve me listat përkatëse F.Z. e RB BH, Nr. 32/06

Statusi

Në FBH,

- ◊ LMM mbulon të gjitha kategoritë¹⁷ përfshi dhe mbetjet nga amabalazhi i plastik dhe krijon një kornizë të përgjithshme për të gjitha aspektet e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Acquis të BE-së.

Në RS,

- ◊ LMM mbulon të gjitha kategoritë e mbetjeve, përfshi përfshi dhe mbetjet nga amabalazhi i plastik dhe krijon një kornizë të përgjithshme për të gjitha aspektet e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me Acquis të BE-së.

Në RBBH,

- ◊ LMM krijon një kornizë të përgjithshme për të gjitha aspektet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në përputhje me Acquis të BE-së.

Të gjitha ligjet e përmendura më lart parashikojnë zhvillimin e planeve të MM dhe Programet e Parandalimit të Mbetjeve (këto të fundit vetëm në RS). Ato duhet të përfshijnë masa që ndikojnë në hartimin dhe prodhimin e produktit (eko-modelimin, teknikat e parandalimit të mbetjeve), si dhe konsumin

17. Përveç mbeturinave radioaktive, ujërave të zeza dhe rrjedhjeve të gazta të emetuara në ajër.

dhe përdorimin e PP (instrumente ekonomike, promovim eko-etiketimi, fushata ndërgjegjësimit, parandalim të gjenerimit të mbetjeve përmes prokurimit publik).

Në dy njësi dhe një distrikt, janë miratuar rregullore për të përcaktuar kategoritë e mbetjeve në përputhje me Katalogun e Mbetjeve të BE-së.

Sfida dhe Mundësi

Në FBH,

- ◇ Plani Federal i Menaxhimit të Mbetjeve përfundoi vlefshmërinë e tij në vitin 2017. Ai

përbante informacion mbi gjenerimin e mbetjeve të paketimit (bazuar në vlerësime) dhe organizimin e propozuar të sistemit të menaxhimit të mbetjeve të paketimit. Në këtë dokument nuk ishte propozuar asnjë masë specifike, vetëm objektiva për riciklimin e paketimeve plastike nga MNB.

- ◇ Një strategji e re është planifikuar në vitin 2019 me mbështetje financiare nga SIDA dhe ndihmë teknike të ofruar nga Agjencia Suedeze e Mjedisit.

Në RS dhe RBBH,

- ◇ Planet e menaxhimit të mbetjeve nuk janë hartuar dhe miratuar ende.

Rregullimi për Mbetjet nga Paketimi

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM) F.Z. e FBH, Nr. 33/03, 72/09 dhe 92/17

Rregullorja për menaxhimin e paketimeve dhe mbetjeve të paketimeve (RMPMP) F.Z. e FBH, Nr. 88/11, 28/13, 08/16, 54/16, 103/16 dhe 84/17

REPUBLIKA E SERBIË

Dekret për Menaxhimin e Paketimit dhe mbeturinave të Paketimit (DMPMP) F.Z. e RS, nr 58/18

RAJONI BRCKO I BH

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Progresi

Në FBH,

- ◇ LMM dhe RMPMP përcaktojnë kërkesat në lidhje me prodhimin, projektimin dhe përdorimin që duhet të përmbushen në

mënyrë që të paketimet të hidhen në tregun e FBH (megjithatë, nuk ka kërkesa specifike për paketimin plastik, por paketimin në përgjithësi).

Në RS,

- ◇ DMPMP përcakton kushtet për hartimin, prodhimin dhe përdorimin e paketimit, menaxhimit të paketimit dhe mbetjeve të tij, kushte të veçanta për lëshimin e lejeve të OPP, si dhe format e raportit për menaxhimin paketimit dhe mbetjeve të paketimit.

Sfida dhe Mundësi

In BD BiH,

- ◇ asnjë rregullore menaxhimin e mbetjeve të paketimit nuk është nxjerrë edhe pse është identifikuar si një përparësi afatshkurtër (2-4 vjet) në Strategjinë e Përafrimit Mjedisor të RB BH, 2017.

Prgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP)

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Rregullorja për menaxhimin e paketimit dhe mbetjeve të paketimit (RMPMP) F.Z. e FBH, Nr. 88/11, 28/13, 08/16, 54/16, 103/16 dhe 84/17

LMM

REPUBLIKA E SERBISË

Dekret për Menaxhimin e Mbetjeve të Paketimit dhe Paketimit (DMPMP) (O.G. e RS, Nr. 58/18)

LMM

RAJONI BRCKO I BH

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Statusi

Në FBH,

◇ *RMPMP* përcakton kërkesat e sistemit të administrimit të mbetjeve të paketimit. Të gjithë prodhuesit kryesorë të UP-ve dhe shitësit me pakicë bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara për subjektet e detyruar të anëtarësohen në sistem. *RMPMP* u lejon atyre të transferojnë detyrimet e tyre direkt te operatori i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ambalazhit (OPP - Organizata e Përgjegjësive të Prodhuesit). Bizneset janë të përjashtuar nga detyrimi për t'u anëtarësuar në sistem nëse, në një vit kalendarik, sasia e materialit paketues të përdorur për paketimin e mallrave nuk tejkalon sasi të caktuara fikse për llojin e paketimit, megjithatë ata janë të detyruar të raportojnë pranë OPP dhe Fondit Federal për Mbrojtjen e Mjedisit për sasi të paketimeve të vendosura në treg si ato që i nënshtrohen menaxhimit të mbetjeve të paketimit. Në rast të mos transferimit të detyrimeve ndaj OPP, importuesit, mbushësit, paketuesit, shpërndarësit dhe furnitorët fundorë paguajnë penaltitetet e përcaktuara në

Fondin Federal për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo tarifë (gjobë) për paketimin plastik është 105 EUR për ton paketim plastik, të vendosur në treg.

◇ Në mënyrë që OPP të marrë lejen e menaxhimit të mbetjeve nga Ministria Federale, duhet të ketë nënshkruar kontrata me të paktën 30 subjekte të cilët hedhin në treg të paktën 30,000 ton paketim në vit.

Në RS,

◇ *DMPMP* përcakton kërkesat e sistemit të menaxhimit të mbetjeve të paketimit. Prodhuesit, importuesit, mbushësit, paketuesit, shpërndarësit dhe furnitorët përfundimtarë janë të detyruar t'i bashkohen sistemit të menaxhimit të mbetjeve të paketimit dhe janë përgjegjës për arritjen e objektivave të përcaktuara të riciklimit. Përndryshe, tarifa e paracaktuar i paguhet Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Efikasitetit të Energjisë së RS dhe konsiderohet si gjobë për mos pjesëmarrjen në PZP. Kjo tarifë (gjobë) për paketimin plastik është 165 EUR për ton paketim plastik, të vendosur në treg.

◇ Në mënyrë që OPP të marrë lejen e menaxhimit të mbetjeve nga Ministria, ajo duhet të nënshkruajë kontrata me të paktën 10 subjekte që vendosin në treg të paktën 8,000 ton paketim në vit.

Ligji për Markat Tregtare (F.Z. e BH, Nr. 25/06) rregullon përdorimin e Pikës (shenjës) së Gjellbër në paketim. Kur kontributi financiar për atë paketim i është paguar një OPP-je kombëtare të kualifikuar, e krijuar në përputhje me parimet e përcaktuara në Direktivën e BE-së për Paketimin dhe Mbetjet nga Paketimet dhe Ligjin përkatës të njëjësive ekonomike, një Pikë e Gjellbër mund të aplikohet në paketim. Përdorimi i Pikës së Gjellbër rregullohet nga parimi "i vendosur në treg", d.m.th. sipas vendit të konsumit jo të prodhimit (aktualisht 7 EUR për ton të paketimeve plastike të vendosura në treg).

Sfida dhe Mundësi

◇ Kuadri rregullator në të dy entitetet përcakton mundësinë e aplikimit të

skemave PZP në menaxhimin e paketimit, përfshirë paketimin plastik, por nuk është e detyrueshme.

- ◇ Përcaktimi aktual i PZP (detyrimi i transferimit në OPP ose nëse nuk paguan tarifa më të larta në Fond) përjashton mundësitë që kompanitë e detyruara të organizojnë individualisht grumbullimin e mbetjeve të paketimit dhe arritjen e objektivave të riciklimit dhe rikuperimit.
- ◇ Rregulloret nuk përcaktojnë përgjegjësitë e prodhuesve të PP, shpërndarësve dhe palëve të tjera të interesit ndaj objektivit të përbashkët të zvogëlimit të mbetjeve të PP. Kufijtë midis grumbullimit dhe riciklimit të përgjegjësive, skemave të financimit, përcaktimit dhe përmbushjes së qëllimeve, sigurimit të mbikëqyrjes dhe qëndrueshmërisë, si dhe ngritjes së fushatave të ndërgjegjësimit nuk janë përcaktuar qartë.
- ◇ Nuk ka një përcaktim të saktë të përgjegjësive për organizimin e grumbullimit dhe riciklimit të veçantë në rast se më shumë se një OPP vepron në treg.
- ◇ Nuk ka përgjegjësi të qarta të Fondit Mjedisor në lidhje me arritjen e objektivave të

riciklimit dhe rikuperimit.

- ◇ Nuk ka të dhëna të besueshme për sasinë e paketimeve të vendosura në treg dhe sasinë e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluara, ricikluara ose eksportuara veçmas. Mbledhja e centralizuar e informacionit dhe menaxhimi i bazës së të dhënave akoma nuk është vendosur.
- ◇ Aktualisht, nuk ka një mekanizëm efektiv për të kontrolluar sasinë e deklaruar. Kjo kufizon burimet e disponueshme në sistem dhe nuk lejon përmirësime të konsiderueshme në praktikën e menaxhimit të mbetjeve¹⁸.
- ◇ Nuk ka asnjë detyrim zyrtar ose nxitje për OPP për të rritur mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të ambalazhit shtëpiak që mund të kontribuojnë në rritjen e niveleve të riciklimit.
- ◇ Ka mungesë konsultimi midis sektorëve përkatës për të përmirësuar skemat ekzistuese të PZP¹⁹.

Sistemi i Kthimit të Depozitave (SKD)

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Sfida dhe Mundësi

- ◇ NJë SKD përdoret në mënyrë informale nga sektori privat për shishet e qelqit.

18. Sipas vlerësimeve jozyrtare, sasinë e përgjithshme të paketimit të padeklaruar tejkalon 50% dhe me shumë mundësi janë rezultat i sasive më të vogla të deklaruara nga kompanitë tashmë të kontraktuara nga OPP-të

19. Impiantet e riciklimit në BH (Natron Maglaj për riciklimin e letrës dhe Omorika Doboj për riciklimin e PET) nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në vendosjen e sistemit PZP. Ata po mbajnë rrugët ekzistuese të furnizimit me mbetje dhe nuk mbështeten plotësisht në OPP-të për atë qëllim. Disa prej tyre madje importojnë 30% të ambalazhit PET nga Kroacia dhe Sllovenia.

Shkurajime Ekonomike

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Dekret për Tarifat për Qeset plastike me Doreza F.Z. e FBH, Nr.9/14

REPUBLIKA E SERBISË

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

RAJONI BRCKO I BH

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Statusi

Në FBH,

- ◇ Dekreti për tarifat për qese plastike me dorezë cakton një tarifë prej 0,025 EUR për një qese polietileni, me ose pa aditivë për degradim, trashësia e të cilave nuk kalon 20 mikron, dhe pa doreza të dizajnuara posaçërisht por me doreza që janë pjesë integrale e qeses plastike (Art 2), ose 25 EUR për një paketë prej 1.000 copë. Qeset e lehta plastike me doreza të përdorura për paketimin e frutave dhe perimeve me shumicë nuk janë objekt i Dekretit.
- ◇ Tarifat mbliidhen nga Fondi Federal i cili më pas ndan 70% të të ardhurave në buxhetet e kantoneve.
- ◇ Tarifat i paguhen Fondit Federal nga të gjithë tregtarët (dyqane me pakicë, dyqane, supermarkete, furra buke, revista, farmaci, dyqane ushqimore, etj.) Të regjistruara në FBH të cilat konsumojnë qese plastike për nevojat e tyre ose i vendosin në treg (Art 3).

Sfida dhe Mundësi

Në FBH,

- ◇ Diferenca midis fushëveprimit të Direktivës (qese plastike me trashësi muri nga 15 në 50 mikron) dhe Dekreti (deri në 20 mikron). Në vitin 2017, Fondi Federativ përgatiti, Draft ndryshimet në Dekret për të harmonizuar më mirë dispozitat e tij me Direktivën e BE (fushëveprimi nga 15 në 50 mikron), por akoma është në pritje të aprovimit. Qeset e lehta plastike me doreza të përdorura për paketimin e frutave dhe perimeve me shumicë nuk janë subjekt i Dekretit
- ◇ Nuk ka asnjë instrument i cili përcakton vlefshmërinë e saktësinë e të dhënave në procesin e raportimit. Rastet e keqreportimit nga shitësit me pakicë po pengojnë ekzekutimin e Dekretit.
- ◇ Implementimi i tarifave për qeset plastike në 2014 në FBH ka zvogëluar konsumin e qeseve plastike (nga 9.3 milion në 2014 në 3.5 milion në 2017), por ky rezultat pozitiv u pengua nga një rritje e përgjithshme e qeseve plastike të vendosura në treg që nuk i nënshtrohen Dekretit (nga 66.4 milion në 69.9 milion në 2017).

Në RS,

- ◇ autoritetet kanë përgatitur kohët e fundit një ndryshim në Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM) duke prezantuar tarifat e qeseve plastike prej 0,15 EUR për kg.

Incentiva Ekonomike

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Ndalimi i produkteve me ndikime negative në mjedis

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Eko-Etiketa

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

● FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Rregullorja 66/2010 / KE mbi Eko etiketën F.Z. e FBH Nr. 92/07

● REPUBLIKA E SERBISË

Rregullorja 66/2010 / KE mbi Eko etiketën F.Z. e RS Nr. 108/13

● RAJONI BRCKO I BH

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Statusi

- ◇ Rregulloret e entitetit për eko etiketimin për paketimet në sektorin e UP janë në përputhje me Rregulloren e BE-së.
- ◇ Këto rregullore përjashtojnë

mundësinë e dhënies së një eko-etikete për produktet ushqimore, por vetë paketimi mund të ketë një eko etiketë.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Në vitin 2012, Ministria Federale dha jua dha eko etiketën 3 kompanive “Eko-etiketal – Shok i Natyrës”, si pjesë e një fushate publike që synon të promovojë produktet e gjelbërta. Gjatë fushatës, përfaqësuesit e Ministrisë Federale deklaruan se eko-etiketat do t’u jepen çdo vit prodhuesve që kanë cilësinë e duhur nga mbrojtja e mjedisit gjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së produktit. Që nga viti 2012 nuk ka informacion të disponueshëm publik për kompanitë të cilat kanë përfunduar këtë etiketë.
- ◇ Nuk ka informacion të disponueshëm nëse ose cilat kompani u është dhënë një eko-etiketë në RS deri më tani.



Eko Inovacioni dhe Eko Dizajni

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Prokurimi i Gjellbër Publik (PGJP)

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Statusi


Në RS,

- ◇ Një ndryshim në LMM parashikon promovimin e parandalimit të mbetjeve përmes prokurimit publik. Asnjë

implementim nuk është regjistruar deri më tani.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Strategjia e Prokurimit Publik për BH (2016-2020) thekson nevojën për të promovuar prokurimin publik të gjellbër, por Plani i tij i Veprimit nuk parashikon ndonjë synim ose plan specifik për PP.



Objektivat e Riciklimit

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji për menaxhimin e mbetjeve (LMM)
“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 064/11
nga 29.12.2011 dhe 039/16 nga 29.06.2016

50% e sasisë totale të mbetjeve nga paketimi (përfshirë metalin, letrën, plastikën dhe qelqin nga familjet dhe burimet e tjera) duhet të përgatiten për ripërdorim dhe riciklim deri në 2020

Statusi

◇ Ligji për menaxhimin e mbetjeve përcakton si objektiv se të paktën 50% të mbetjeve të grumbulluara, të tilla si letra, metali, plastika dhe qelqi nga familjet dhe burimet e tjera duhet të përgatiten për riciklimin.

Ky synim është planifikuar të arrihet

deri në vitin 2020 duke ndjekur këto objektiva:

- 25% të rociklohen deri më 31 dhjetor 2017;
- 35% të rociklohen deri më 31 dhjetor 2018;
- 45% të rociklohen deri më 31 dhjetor 2019;
- 50% të rociklohen deri më 31 dhjetor 2020.

Sfida dhe Mundësi

◇ Sipas Raportit për zbatimin e planit shtetëror të menaxhimit të mbetjeve, vetëm 10% e mbetjeve totale të grumbulluara ishin përgatitur për ripërdorim dhe riciklim në 23 bashki në vitin 2017.

Rregullimi i Menaxhimit të Mbetjeve

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji për menaxhimin e mbetjeve (LMM)
“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 064/11
nga 29.12.2011 dhe 039/16 nga 29.06.2016

Ligji për shërbimet bashkiake “Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 055/16 nga 17.08.2016 dhe 074/16 nga 01.12.2016

Rregullore për metodologjinë e përcaktimit të përbërjes dhe sasisë së mbetjeve bashkiake në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore “Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 025/18 nga 20.04.2018

Statusi

◇ Sipas LMM, prodhuesit janë të detyruar të miratojnë çdo teknologji / proces për të zvogëluar / parandaluar gjenerimin e mbetjeve. Nëse prodhojnë më shumë

se 200 kg ose mbetje të rrezikshme ose 20 tonë mbetje jo të rrezikshme, ata janë të detyruar të përgatisin një Plan për Menaxhimin e Mbetjeve.

- ◇ Paketimi i UP-ve nuk përmendet specifikisht dhe nuk njihet në LMM. Mbetjet nga paketimi detajohen vetëm si mbetje komerciale ose bashkiake.
- ◇ Rregullorja është një akt nënligjor që përcakton metodologjinë për përcaktimin e përbërjes dhe sasisë së mbetjeve bashkiake në territorin e njësisive të vetëqeverisjes vendore nga Shërbimet Bashkiake dhe sipas Katalogut të Mbetjeve të BE-së.
- ◇ Pas miratimit të LMM, ndërmjet viteve 2012-19, janë lëshuar 441 leje për menaxhimin e mbetjeve.
- ◇ Plani Shtetëror i Menaxhimit të Mbetjeve 2015-20²⁰ u miratua në korrik 2015 dhe u amendua²¹ më pas. Ky Plan propozon krijimin e katër qendrave për menaxhimin e mbetjeve, një sistem kontejnerësh për grumbullimin e

mbetjeve 'të njoma' dhe 'të thata'.

- ◇ Në vitin 2018, sipas Raportit për Zbatimin e Planit Shtetëror të Menaxhimit të Mbetjeve, 14 Bashki kanë përgatitur dhe miratuar planet lokale të menaxhimit të mbetjeve.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Një plan i ri Shtetëror për Menaxhimin e Mbetjeve është duke u hartuar aktualisht si dhe për të krijuar një bazë të dhënash të njëjtë ndërmjet Agjencisë për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit dhe MONSTAT; dhe për të forcuar kapacitetet e inspektorëve për punë të mëtejshme në menaxhimin e mbetjeve.
- ◇ Deri më tani, me përjashtim të Rregullores, nuk është krijuar ndonjë bazë e të dhënave adekuate për përbërjen e mbetjeve.
- ◇ Nuk ekziston asnjë plan kombëtar për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve.

Rregullimi për Menaxhimin e Mbetjeve nga Paketimi

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Rregullore për mënyrën dhe procedurën e krijimit të sistemit për tërheqjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve nga paketimi dhe funksionimin e këtij sistemi "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 42/12 nga 31.07.2012

Strategjia Kombëtare me plan veprimi për transpozimin, implementimin dhe

zbatimin e acquis të BE-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike 2016-20

Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve për kryeqytetin, Podgoricën, për periudhën 2016-20

Statusi

- ◇ Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 94/62 / EK e 20 dhjetorit 1994 mbi

20. Plan Shtetëror i Menaxhimit të Mbetjeve në Mal të Zi për periudhën 2015 - 2020, "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 74/15 nga 23.12.2015

21. Vendim për ndryshimet në Planin Shtetëror të Menaxhimit të mbetjeve për periudhën 2015 - 2020, "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi" Nr. 035/18

paketimin dhe mbetjet e paketimit është transpozuar në pjesën më të madhe, ligji ekzistues duhet të rishikohet dhe të hartohen aktet nënligjore.

- ◇ Rregullorja përcakton:
 - metodat dhe procedurat për krijimin dhe funksionimin e një sistemi për mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve të paketimit. Ai vlen për paketimin që është hedhur në treg dhe mbetjet e paketimit të gjeneruara brenda industrisë, artizanatit, tregtisë, shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera, si dhe për objektet që kanë karakteristika të ngjashme me paketimin.
 - Shërbimet bashkiake janë të detyruara të sigurojnë një numër të mjaftueshëm ishujsh të gjelbër (vende

me kontejnerë për ndarjen primare të mbetjeve) dhe oborret e riciklimit.

- ◇ Një person juridik që përpunon mbetje nga paketimi është i detyruar të mbajë shënim sasinë e mbetjeve nga paketimi që ai përpunon.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Strategjia Kombëtare njeh menaxhimin e mbetjeve si një përparësi kombëtare dhe propozon një bashkëpunim midis Ministrisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe MONSTAT për të hartuar aktet nënligjore që do të përcaktojnë grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në lidhje me mbetjet. Megjithatë, hartimi e ligjeve dhe akteve nënligjore mbetet prapa.

Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP)

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve (LMM)
“Fletorja Zyrtare e Malit të Zi”, Nr. 064/11 nga 29.12.2011 dhe 039/16 nga 29.06.2016

Statusi

- ◇ Një skemë kombëtare PZP është parashikuar brenda LMM.
- ◇ Një regjistër i prodhuesve me përgjegjësi të zgjeruar menaxhohet nga Agjencia për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Për shkak të mungesës së akteve nënligjore dhe dispozitave të pa zbatueshme, PZP nuk implemtohet dhe zbatohet.
- ◇ Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, Drejtoria për Menaxhimin e Mbetjeve, planifikon të propozojë Ligjin e ri për menaxhimin e mbetjeve për të siguruar zbatimin e skemës PZP.



Sistemi i Kthimit të Depozitës (SKD)

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Birraria Trebjesa, e cila është birraria më e madhe në Malin e Zi, krijoi në mënyrë të njëanshme një SKD për shishet e qelqit e cila ka qenë jashtëzakonisht e suksesshme. Kjo tregon se njerëzit në Malin e Zi janë të gatshëm të pranojnë skema të ngjashme, veçanërisht pasi shohin avantazhin ekonomik.
- ◇ Një SKD për kuti polistireni të zgjerueshëm në sektorin e peshkimit ishte planifikuar, por nuk u implementua.

Shkurajime Ekonomike

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

*Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit
"Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 2/2014,
6/2014, 43/2015 dhe 70/2017*

Statusi

- ◇ Ligji për mbrojtjen e konsumatorit përcakton se tregtari është i detyruar t'i sigurojë konsumatorit materiale të përshtatshme për paketim, në përputhje me natyrën dhe karakteristikat e mallrave. Supermarketet mund të

ngarkojnë një pagesë shtesë për qeset plastike një përdorimshe, por nëse qeset mbajnë një logo, shenjë ose një mesazh marketingu / komunikimi të shitësit me pakicë, ato mund të jepen falas. Qeset plastike për mbajtjen e produkteve të blear të cilat kanë logon, shenjën, sloganin dhe / ose emrin e prodhuesit ose tregtarit konsiderohen si një material promovues dhe nuk duhet të ngarkohen me një pagesë shtesë.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Deri më tani, ngarkimi i një pagese shtesë për qeset plastike një përdorimshe nuk ka pasur impakt në sasinë e qeseve të prodhuara dhe

Incentiva Ekonomike

● Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Ndalimi i produkteve me ndikime negative në mjedis

- **Strategji, ligje dhe akte nënligjore**
NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Eko-Etiketa

● **Strategji, ligje dhe akte nën ligjore**

Ligji për Mjedisin Zakon o životnoj sredini, "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", bnr 52, e 09. Gusht 2016

Plani Shtetëror i Menaxhimit të Mbetjeve 2015-20

Sistemi i BE-së për Eko Etiketën

- ◇ Plan Shtetëror i Menaxhimit të Mbetjeve 2015-20 njih nevojën e Malit të Zi për të përcaktuar një Eko Etiketë ose çertifikim për të promovuar ekonominë qarkulluese dhe propozon gjithashtu një çmim për qytetarët që zbatojnë rregullisht ndarjen e mbeturinave për të rritur vetëdijen për arritur përqindje më të larta riciklimi.

Statusi

- ◇ Referuar Ligjit për Mjedisin, personat juridikë ose individët mund të aplikojnë për Eko Etiketën për produktet ose shërbimet që përfshijnë zvogëlimin e konsumit të energjisë, prodhimin e materialeve të dëmshme dhe të rrezikshme, të mbetjeve ose të konsumit të burimeve natyrore.
- ◇ Eko Etiketa e BE-së mund të jepet përmes një auditori të licencuar të një shteti anëtar të BE-së. Që nga viti 2012, 14 biznese turistike i është dhënë Eko Etiketa.

Sfida dhe Mundësi

- ◇ Për shkak të një prodhimi të kufizuar të brendshëm të UP-ve, nuk ka pasur interes për Eko Etiketat në Malin e Zi. Shumica e produkteve që janë në përdorim të përditshëm në Mal të Zi importohen dhe kanë një Eko Etiketë të lëshuar nga një vend i BE-së. Megjithatë, bizneset në Malin e Zi kanë kuptuar që Eko Etiketa mund t'u japë atyre një avantazh konkurrues.



Eko Inovacioni dhe Eko Dizajni

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

NUK ËSHTË E RREGULLUAR

Sfida dhe Mundësi

◇ Mali i Zi ka filluar të importojë UPPP të eko dizajnuar, por ato janë më të shtrenjta se UPPP tradicionale.

◇ Asnjë prodhim vendas në fushën e UPPP-së nuk ka aplikuar eko inovacionin apo eko dizajnin

◇ UPPP i kompostueshëm importohet por sigurojnë pak përfitime pasi nuk ekziston asnjë strukturë industriale për kompostim në Malin e Zi.

Prokurimi i Gjellbër Publik (PGJP)

Strategji, ligje dhe akte nën ligjore

Ligji për Prokurimin Publik "Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 042/11 nga 15.08.2011, 057/14 nga 26.12.2014, 028/15 nga 03.06.2015, 042/17 nga 30.06.2017

Statusi

◇ Ligji për prokurimin publik rregullon kushtet, mënyrën dhe procedurat e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe dorëzimit të punimeve si dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me prokurimin publik. Parimi dhe kriteret kryesore bazohen në aspektin ekonomik (çmimin).

Sfida dhe Mundësi

◇ Asnjë kriter i cili siguron parimin e qëndrueshmërisë në lidhje me parandalimin e gjenerimit të mbetjeve nga UPPP-ja nuk është aplikuar deri më tani në Malin e Zi. Cmimi mbetet kriteri më i rëndësishëm për prokurimin publik.

◇ Në vitin 2018, programi "Le të blejmë produkte vendase" u lançua për të promovuar produktet vendase: më shumë se 3,000 produkte janë tani në tregjet malazeze me këtë etiketë. Për shembull, që nga fillimi i vitit 2019, Qeveria për nevojat e saj merrë furnizohet ekskluzivisht nga ndërmarrja lokale e ujit mineral "Rada" (e cila u rihap me këtë qëllim).

